

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT**



PUNIMI - MASTER

**KRAHASIMI I NIVELIT TË AKTIVITETIT FIZIK REKREATIV
TEK TË RINJËT E ZONËS URBANE DHE RURALE TË
KOMUNËS SË PEJËS**

**Mentori:
Prof. Dr. Bujar Turjaka**

**Kandidatja:
Ajshe Shala**

Prishtinë, 2025

**UNIVERSITY OF PRISHTINA
FACULTY OF PHYSICAL EDUCATION AND SPORT**



MASTER THESIS

**COMPARISON OF THE LEVEL OF RECREATIONAL
PHYSICAL ACTIVITY AMONG YOUTH IN URBAN AND
RURAL AREAS OF PEJA MUNICIPALITY**

Mentor:

Prof.dr. Bujar Turjaka

Candidat:

Ajshe Shala

Prishtinë, 2025

DEDIKIM

Familjës time

FALËNDERIM

Me përfundimin e këtij punimi, ndjej detyrimin dhe kënaqësinë që të shpreh mirënjohjen time të thellë për të gjithë ata që më kanë mbështetur gjatë këtij rrugëtimi akademik.

Së pari, falënderoj mentorin **Prof. Dr. Bujar Turjaka** për ndihmën e ofruar dhe durimin gjatë përgatitjes së këtij punimi të Diplomës Master, si dhe profesorët për udhëzimet dhe përkushtimin e tyre gjatë këtyre viteteve të studimeve.

Falënderime të veçanta për familjen time për durimin, dashurinë dhe përkrahjen e pakushtëzuar gjatë gjithë kohës. Pa mbështetjen e tyre të vazhdueshme kjo arritje nuk do të kishte qenë e mundur.

Abstrakt

Ky hulumtim ka analizuar nivelin e përfshirjes së nxënësve të klasës së VIII nga Komuna e Pejës në aktivitetet fizike dhe qëndrimet e tyre ndaj edukatës fizike, duke marrë parasysh ndikimin e gjinisë dhe vendbanimit (urbane vs. rurale). Mostra përbëhej nga 200 nxënës, përkatësisht 100 djem dhe 100 vajza, të ndarë në mënyrë të barabartë sipas vendbanimit: 50 djem dhe 50 vajza nga zona urbane, dhe 50 djem dhe 50 vajza nga zona rurale. Qëllimi kryesor ishte vlerësimi i ndryshimeve në masat antropometrike (lartësia, pesha, BMI) dhe perceptimet për aktivitetin fizik, kushtet e zhvillimit dhe barrierat në përfshirje. Përpunimi i të dhënave u realizua me SPSS, duke përdorur analiza përshkruese, t-teste për grupe të pavarura, si dhe testet joparametrike Mann–Whitney dhe Kruskal-Wallis për të identifikuar dallimet statistikisht të rëndësishme mes grupeve. Rezultatet treguan dallime antropometrike të rëndësishme vetëm tek vajzat mes grupeve urbane dhe rurale, me avantazh për vajzat urbane, ndërsa tek djemtë dallimet nuk ishin statistikisht të rëndësishme. Kjo sugjeron ndikim më të fortë të faktorëve ambientale dhe socio-ekonomikë tek zhvillimi trupor i vajzave. Përfshirja në aktivitet fizik ndryshon në bazë të gjinisë dhe vendbanimit: djemtë urbanë janë më aktivë sesa ata ruralë, ndërsa vajzat rurale janë më pak aktive krahasuar me vajzat urbane. Motivimi për aktivitetin fizik ndryshon gjithashtu, ku djemtë urbanë fokusohen kryesisht te shëndeti, ndërsa grupet rurale te humbja në peshë. Nxënësit urbanë shfaqin më shumë kënaqësi dhe vetëvlerësim ndaj edukatës fizike, ndërsa ata ruralë përballen me më shumë sfida dhe interes më të ulët. Megjithatë, angazhimi gjatë orëve të edukatës fizike është relativisht i barabartë në të gjitha grupet. Rëndësia e edukatës fizike për shëndetin pranohet gjerësisht pavarësisht dallimeve në përfshirje dhe perceptim. Këto gjetje theksojnë nevojën për politika dhe ndërhyrje që adresojnë pabarazitë në infrastrukturë dhe motivim, duke siguruar mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit në edukatën fizike, me qëllim përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së komunitetit të Pejës.

Fjalët kyçe: Aktiviteti fizik, Nxënës të klasës së VIII, Komuna e Pejës, Zonë urbane, Zonë rurale, anketa, statistika

Abstract

This study analyzed the level of participation of 8th-grade students from the Municipality of Peja in physical activities and their attitudes towards physical education, considering the influence of gender and place of residence (urban vs. rural). The sample consisted of 200 students, equally divided by gender and residence: 100 boys and 100 girls, with 50 boys and 50 girls from urban areas, and 50 boys and 50 girls from rural areas. The main objective was to assess differences in anthropometric measures (height, weight, BMI) and perceptions regarding physical activity, conditions for development, and barriers to participation. Data processing was carried out using SPSS, employing descriptive analyses, independent samples t-tests, as well as non-parametric Mann–Whitney and Kruskal-Wallis tests to identify statistically significant differences between groups. Results showed significant anthropometric differences only among girls between urban and rural groups, with an advantage for urban girls, while differences among boys were not statistically significant. This suggests a stronger influence of environmental and socio-economic factors on the physical development of girls. Participation in physical activity varies by gender and residence: urban boys are more active than rural boys, while rural girls are less active compared to urban girls. Motivation for physical activity also differs, with urban boys focusing primarily on health, while rural groups emphasize weight loss. Urban students demonstrate higher satisfaction and self-esteem regarding physical education, whereas rural students face more challenges and show less interest. However, engagement during physical education classes is relatively equal across all groups. The importance of physical education for health is widely acknowledged despite differences in participation and perception. These findings highlight the need for policies and interventions that address inequalities in infrastructure and motivation, ensuring equal opportunities for all students in physical education, with the goal of improving the health and well-being of the Peja community.

Keywords: Physical activity, 8th-grade students, Municipality of Peja, Urban area, Rural area, Survey, Statistics

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	1
2. HULUMTIMET E DERITANISHME	6
3. SUBJEKTI, PROBLEMI DHE QËLLIMI I HULUMTIMIT	12
5. HIPOTEZA E PUNIMIT	13
5. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	14
5.1. Rrjedha dhe procedurat e hulumtimit	14
5.2. Mostra e të anketuarve	14
5.3. Mostra e instrumenteve të matjes	15
5.4. Përshkrimi i matjeve	18
5.4.1. Përshkrimi i matjeve antropometrike.....	18
5.5. Përpunimi statistikor i të dhënave.....	21
6. INTERPRETIMI DHE DISKUTIMI.....	22
6.1. Parametrat statistikor themelor	22
6.1.1. Parametrat statistikor të ndryshoreve antropometrike te djemt dhe vajzat të viseve urbane dhe rurale.....	22
6.2. Analiza e dallimeve.....	25
6.2.1. Analiza e dallimeve ndermjet djemve nga viset urbane dhe rurale	25
6.2.2. Analiza e dallimeve ndermjet vajzave nga viset urbane dhe rurale.....	27
6.3. Analiza joparametrike.....	29
6.3.1. Dallimet ndërmjet djemve nga viset urbane dhe rurale si dhe vajzave nga viset urbane dhe rurale.....	29
6.4. Dalimi ndërmjet grupeve	47
6.5. Vërtetimi i hipotezave të punimit	59
7. PËRFUNDIM	62
8. RËNDEsia TEORIKE DHE PRAKTIKE.....	64
9. LITERATURA	65

1. HYRJJE

Duke e përkufizuar kohën e lirë (Dumazedier, 1972; Irby dhe Tolman, 2002), theksojnë se ajo përfshin ato orë të ditës kur të rinjtë nuk janë të angazhuar formalisht në aktivitete shkollore, familjare apo të punës. Si aktivitete të kohës së lirë përmenden ato që të rinjtë i zgjedhin lirisht, prandaj konsiderohen si e drejtë diskrecionale e tyre. Koha e lirë është ajo kohë që i mbetet fëmijës pas përbushjes së të gjitha detyrimeve shkollore dhe të tjera.

Përpara njeriut modern vazhdimisht paraqiten kërkesa gjithnjë e më të reja nga shoqëria konsumatore, të cilat duhet të përbushen që si shpërblim të fitohet e ashtuquajtura 'kohë e lirë' (Polić, 2003). Koha e lirë është një parakusht për shumë aktivitete, një pjesë e madhe e të cilave i nënshtrohet faktorëve të rëndësishëm që ndikojnë në funksionimin e njeriut në kuadër të drejtimeve të ndryshme shoqërore dhe ekonomike të jetës (Andrijašević, 2000). Lindja dhe zhvillimi i shoqërisë industriale, përveç pasojave të tjera, ka rezultuar në lindjen, përkatësisht formësimin specifik të kategorisë së të rinjve, si dhe të kategorisë së kohës së lirë (Perasović, 2009). Aktivitetet dhe hapësira e kohës së lirë janë kuptuar si mjete të rëndësishme për fuqizimin e të rinjve, si edhe si një sferë për realizimin e interesave të çdo individi apo grupi (Jeđud dhe Novak, 2006). Hulumtimi i fenomenit të kohës së lirë ka vetëm një qëllim parësor, dhe ai është që koha e lirë të organizohet sa më mirë, dhe rrjedhimisht të shfrytëzohet në mënyrë cilësore. Duke qenë se aktivitetet e lira i zgjedh individi vetë, ato i ofrojnë atij ndjenjën e lirisë dhe kontrollit personal shumë më tepër sesa aktivitetet e tjera, siç janë shkolla apo puna. Koha e lirë, pra, duhet të jetë kulmi i përjetimit të kënaqësisë dhe lumturisë, dhe si e tillë, një pjesë e pandashme e kodit të njeriut modern (Bouillet, 2008.)." Koha e lirë e të rinjve ka qenë gjithmonë në qendër të vëmendjes si një fenomen shoqëror, me qëllim gjetjen e përmbajtjeve që do t'i motivonin të rinjtë ta kalonin kohën e lirë në aktivitete fizike. Këtë detyrë shoqërore, e cila është shumë e rëndësishme, e ka marrë përsipër shkolla si institucion edukativo-arsimor, që është në gjendje të drejtojë aktivitetet jashtëmësimore dhe jashtëshkollore, si në aspektin teorik ashtu edhe praktik, drejt një kulture të shfrytëzimit të kohës së lirë (Previšić, 2000). Përmbajtjet dhe format e kalimit të kohës së lirë bëhen variabla të rëndësishme për të kuptuar efikasitetin e edukimit në përgjithësi, e veçanërisht në kuadër të sistemit shkollor (Leburić dhe Relja, 1999).

Hulumtimet e deritanishme tregojnë se "koha e lirë është ajo fushë e jetës së përditshme në të cilën të rinjtë bëhen të pavarur më herët dhe ku autonomia e tyre është më e madhe" (Ilišin et al., 2006). Vetë termi aktivitete jashtëmësimore apo të lira nënkupton ekzistencën e kushteve themelore psikologjike për zhvillimin e kreativitetit — lirinë dhe sigurinë psikologjike — që për nxënësit përbëjnë një faktor të fuqishëm motivues për pjesëmarrje. Potenciali krijues i individit kërkon një ambient dhe kushte të caktuara në mënyrë që të zhvillohet dhe të realizohet lirisht (Mlinarević–Brust, 2009). Fëmijëve që kanë vullnet dhe ndjeshmëri për këtë u rekomandohet të merren me sport, ndërsa të tjerëve, që nuk kanë ambicie sportive, u rekomandohet të merren me aktivitete rekreative, të cilat janë të qasshme për të gjithë. Gjithashtu, rekomandohet që fëmijët dhe të rinjtë të shfrytëzojnë kohë pas kohe një pjesë të kohës së lirë për t'u marrë me aktivitete të dobishme dhe interesante nga fusha të ndryshme si: muzika, arti pamor dhe aktivitete të tjera kreative. Në mjedise të ndryshme (rajonale), nxënësi fiton përvoja të ndryshme, kryen aktivitete të ndryshme dhe është i ekspozuar ndaj ndikimeve dhe pritshmërive të ndryshme nga personat me të cilët takohen. Çdo mjedis ka potenciale edukativo-arsimore specifike (Rosić, 2001).

Procesi edukativ gjithmonë zhvillohet në një kontekst të caktuar dhe në një mjedis më shumë apo më pak të favorshëm për edukim. Në kohën dhe hapësirën ku individi zhvillohet, mjedisi edukativ përfshin: ambientin fizik, social, kulturor, psikik dhe fetar. Shoqëria bashkëkohore përbëhet nga mjedise të ndryshme që mund të kenë ndikim edukativ. Meqenëse fëmijët i zgjedhin vetë aktivitetet, është i pranishëm një nivel i lartë motivimi që mundëson përfshirje të gjerë dhe përvetësim më të lehtë të njohurive. Aktivitetet e të rinjve janë të ndryshme në rajone të ndryshme dhe interesat e tyre varen nga një sërë faktorësh, si: gjeografikë (vendi i banimit), ekonomikë (zhvillimi i mjedisit), mendorë, niveli i interesimit, gjinia, moshja, profesioni etj.

Koha e lirë është ai segment i jetës njerëzore në të cilin njeriu para së gjithash e njeh veten si individ me të gjitha veçoritë, interesat, motivet e tij (Grandić dhe bashkëpunëtorët, 2009).

Rëndësia e interesave personale për mënyrën se si të rinjtë e kalojnë kohën e lirë konfirmohet nga rezultatet e hulumtimeve me nxënës të shkollave fillore (Havelka dhe bashkëpunëtorët, 1990). Përafërsisht gjysma e nxënësve e kalojnë kohën e lirë në shtëpi, ndërsa gjysma tjetër jashtë saj. Kur largohen nga shtëpia, të rinjtë më së shpeshti shkojnë në fusha sportive, parqe, rrugë apo sheshe publike. Përgjithësimi i rezultateve i çon autorët në

përfundimin se në strukturën e kohës së lirë të nxënësve në fund të arsimit fillor dominojnë aktivitetet fizike, ndërsa në mesin e aktiviteve njohëse – ato receptive. Prandaj, në jetën e të rinjve ka pak rrethana që do të nxisnin produktivitetin dhe kreativitetin (Maksić dhe bashkëpunëtorët, 2008). Zhvillimi i një kulture të mirëfilltë të përdorimit të kohës së lirë është thelbësor për formimin e plotë të personalitetit të të rinjve. Koha e lirë nuk duhet të jetë vetëm pushim pas detyrimeve ditore, por një mundësi për rritje personale dhe sociale. Aktivitetet që nxisin kreativitetin si leximi, muzika, arti, shkrimi, programimi apo pjesëmarrja në projekte vullnetare janë mënyra të dobishme për ta shfrytëzuar këtë kohë.

Për më tepër, teknologjia moderne ka ndryshuar mënyrën se si të rinjtë e kalojnë kohën e lirë. Rrjetet sociale, lojërat elektronike dhe platforma të tjera dixhitale kanë zënë një pjesë të madhe të kësaj kohe. Edhe pse këto aktivitete mund të ofrojnë forma të argëtimit dhe komunikimit, ato shpeshherë nuk kontribuojnë në zhvillimin e aftësive reale apo në nxitjen e krijimtarisë. Prandaj, është e rëndësishme që prindërit, arsimtarët dhe institucionet edukative të ndërjegjësojnë të rinjtë për rëndësinë e balancimit mes argëtimit pasiv dhe aktiviteteve produktive. Organizimi i klubeve të interesit, kurseve jashtëshkollore dhe punëtorive krijuese mund të jetë një mënyrë efektive për t'i orientuar të rinjtë drejt përdorimit më të dobishëm të kohës së lirë (Aarnio, 2003).

Periudha e shkollës fillore është një fazë e rëndësishme për formimin e interesave personale dhe për përfshirjen e fëmijëve në aktivitete të ndryshme të kohës së lirë. Gjatë kësaj kohe, ata ndeshen me lloje të shumta aktiviteteve që ndikojnë në zhvillimin e tyre individual dhe shoqëror. Këto përfshijnë aktivitete jashtëshkollore si sportet, artet, aktivitetet kulturore, si dhe ato më pasive si shikimi i televizorit, përdorimi i rrjeteve sociale apo dëgjimi i muzikës.

Bazuar në këtë qasje, studimi i realizuar ka nisur nga ideja se fëmijët zakonisht zgjedhin sportin si mënyrë më të preferuar për të kaluar kohën e lirë. Sporti jo vetëm që ofron lëvizje fizike dhe argëtim, por gjithashtu ndihmon në ndërtimin e vetëdisiplinës, punës në grup dhe vetëbesimit. Në shoqëritë moderne, koha e lirë shihet si një pjesë shumë e rëndësishme e zhvillimit të të rinjve në aspektin emocional, mendor dhe shoqëror. Përveç argëtimit, ajo përfshin edhe përfshirjen aktive të të rinjve në kulturë, media, teknologji informative, si dhe në aktivitete sportive dhe edukative që ndodhin jashtë shkollës (Andrijašević, 2000).

Aktivitetet në kohën e lirë luajnë rol kyç në zhvillimin e ndjenjës së përkatësisë, në forcimin e marrëdhënieve me bashkëmoshatarët dhe në kultivimin e shprehive të shëndetshme të

sjelljes. Megjithatë, është e domosdoshme që organizimi i këtyre aktiviteteve të bëhet me kujdes, në mënyrë që të rinjtë të mos izoloohen apo manipulohen përmes përmbajtjes së tyre. Koha e lirë duhet të shfrytëzohet si mundësi për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe për realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve për zhvillim të shëndetshëm. Ajo gjithashtu mund të ndihmojë në parandalimin e dukurive negative si varësia ndaj substancave narkotike, konsumimi i alkoolit, dhuna apo sjelljet devijante në shoqëri. Prandaj, është detyrë e përbashkët e shkollave, familjes dhe institucioneve shoqërore të krijojnë kushte që nxisin përfshirjen e fëmijëve në aktivitete të dobishme, që jo vetëm i argëtojnë, por edhe i ndihmojnë të rriten si individë të përgjegjshëm dhe aktivë në komunitet (Grandić dhe bashkëpunëtorët, 2009)

Sporti dhe aktiviteti fizik, në veçanti, kanë një rol të rëndësishëm në procesin edukativo-arsimor të të rinjve, pasi ndikojnë në zhvillimin e aspekteve fizike, psikologjike dhe sociale të tyre. Përfshirja e të rinjve në aktivitete sportive dhe rekreative duhet të reflektojë karakteristikat e tyre individuale dhe të kontribuojë në ndërtimin e një personaliteti të balancuar. Këto aktivitete ndihmojnë në përvetësimin e vlerave të sportit, si respekti, ndershmëria, bashkëpunimi, qëndrueshmëria, vetëbesimi dhe një frymë e shëndetshme garimi (Nešić dhe bashkëpunëtorët, 2011). Një nga sfidat kryesore të brezit të ri sot është mungesa e mjaftueshme e aktivitetit fizik, fenomen i përhapur në të gjitha shtresat e shoqërisë. Reduktimi i lëvizjes dhe aktivitetit trupor ndikon negativisht në shëndetin fizik dhe mendor të të rinjve.

Përveç sporteve ekipore të njohura si volejboli, hendbolli, basketbolli dhe futboli, në shkolla duhet të organizohen vazhdimisht programe që kanë si qëllim parandalimin e mbipeshës. Këto programe duhet të përfshijnë aktivitete të ndryshme sportive, në mënyrë që edhe nxënësit që kanë peshë të shtuar të mund të përfshihen pa u ndjerë inferior për shkak të rezultateve apo pamjes së tyre fizike (Vidaković dhe bashkëpunëtorët, 2011).

Ushtrimet fizike të kryera rregullisht kanë shumë efekte pozitive në shëndetin e njeriut. Ndërsa fëmijët kanë tendencë natyrale për aktivitet, me kalimin e kohës ata bëhen më pak aktivë. (Aarnio, 2003). Për këtë arsye, është e rëndësishme që në moshë të vogël të krijohet një zakon për aktivitetin fizik dhe të nxiset kuptimi i rëndësishëm së sporteve dhe aktiviteteve rekreative. (Ostojić dhe bashkëpunëtorët, 2010). Aktiviteti fizik dhe angazhimi në sport lidhen ngushtë me sjelljet që ndikojnë në shëndetin, si dhe me faktorë të ndryshëm shoqërorë (Sallis dhe bashkëpunëtorët, 2000).

Stili i jetës dhe puna moderne kanë sjellë ndryshime të mëdha, jo vetëm në natyrën dhe intensitetin e detyrave në punë, por edhe në mënyrën se si njerëzit shfrytëzojnë kohën e tyre të lirë dhe pushimin. Meqë shumë nga aktivitetet e sotme profesionale nuk përfshijnë lëvizje të mjaftueshme muskulore dhe aktivitet motorik optimal, i nevojitet organizmit të njeriut të gjenden forma të ndryshme aktivitetesh që në kohën e lirë mund të plotësojnë nevojat bazë të njeriut për lëvizje, relaksim, komunikim, lojë dhe argëtim, duke kontribuar kështu në përmirësimin e cilësisë së jetës (Grandić dhe bashkëpunëtorët, 2009)

Sot, shoqëria gjithnjë e më shumë përqafon mënyra aktive të pushimit, edhe gjatë orarit të punës, duke aplikuar programe të ndryshme sportive dhe rekreative, si ushtrime për formësim trupor, aktivitete argëtuese dhe elemente nga lojërat sportive. Këto aktivitete janë natyrale për lëvizjen dhe përshtaten me gjendjen shëndetësore, aftësitë, nevojat dhe interesat e secilit individ, qoftë me vetëdije apo pa (Nešić dhe bashkëpunëtorët, 2011).

Duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm që sporti dhe rekreacioni sportiv kanë në plotësimin e nevojave themelore të njeriut për lëvizje, ato janë gjithashtu pjesë e trendeve të reja turistike. Turizmi po ndryshon nga ofertat tradicionale të pushimit drejt programeve aktive që përfshijnë sporte dhe rekreacion në ambiente natyrore tërheqëse.

Në shëndetin e njerëzve modernë ndikojnë negativisht ushqimi i tepërt dhe jo i përshtatshëm, mungesa e aktivitetit fizik, stresi, ndotja e mjedisit dhe zakonet e dëmshme. Këto faktorë, së bashku me mungesën e lëvizjes dhe ngarkesat emocionale, janë shkaktarë kryesorë të sëmundjeve të ndryshme si ato të sistemit muskular, zemrës, aparatit të frymëmarrjes dhe tretjes, si dhe problemeve nervore dhe emocionale. Aktiviteti fizik i rregullt dhe i përshtatshëm është i domosdoshëm për ruajtjen e shëndetit dhe funksionimin normal të trupit. Çdo kufizim i madh i lëvizjes është në kundërshtim me natyrën biologjike të njeriut dhe mund të shkaktojë probleme funksionale e më vonë edhe dëmtime organike të organeve jetësore. Kjo mungesë e aktivitetit mund të kompensohet përmes programeve adekuate të rekreacionit sportiv.

Në psikologji, personaliteti është koncepti më kompleks dhe më gjithëpërfshirës, i cili përdoret për të përshkruar dhe shpjeguar sjelljet gjatë trajnimit sportiv. Marrëdhënia midis personalitetit dhe trajnimit sportiv ndikohet nga disa faktorë të ndryshëm. Personaliteti, përveç ndikimit nga faktorët situacionalë, organikë, socialë dhe social-historikë, përbën një pjesë të pandashme të determinimeve që ndikojnë në çdo veprim të individit, përfshirë edhe pjesëmarrjen në aktivitete të ndryshme të trajnimit sportiv. (Ostojčić dhe bashkëpunëtorët, 2010).

2. HULUMTIMET E DERITANISHME

Gjatë dhjetë viteve të fundit është vërejtur një ulje e përgjithshme e aktivitetit fizik në të gjitha moshat. Kjo ndodh kryesisht si pasojë e modernizimit të mënyrës së punës dhe jetës së përditshme, ku përdorimi i teknologjisë dhe pajisjeve të ndryshme ka çuar në minimizimin e nevojës për lëvizje fizike. Gjithashtu, tërheqja që kanë programet dhe përmbajtjet e mediave elektronike, si televizioni, interneti dhe telefonat inteligjentë, ka kontribuar në këtë rënie.

Në lidhje me vlerësimin e nivelit të aktivitetit fizik në popullata të ndryshme, janë realizuar një sërë studimesh në mbarë botën. Për të pasur një kuptim më të thellë të problematikës, është thelbësore që këto studime të vazhdojnë. Meqë ekziston një mungesë e konsiderueshme e kërkimeve që fokusohen posaçërisht në personat e moshës së re, do të jetë e nevojshme që të merren parasysh edhe të dhënat nga studimet që përfshijnë popullatën e gjerë në vende të ndryshme. Rezultatet e këtyre hulumtimeve do të paraqiten në pjesën në vijim të materialit.

Burton dhe Turrell (2000), në një hulumtim të realizuar në Australi, kanë analizuar marrëdhënien midis profesionit, kohës së kaluar në punë dhe nivelit të aktivitetit fizik në kohën e lirë tek individët e moshës së mesme. Mostra ka përfshirë 21,787 të anketuar. Rezultatet treguan se 67.7% e tyre nuk ishin mjaftueshëm aktivë fizikisht, ku gratë (72.2%) rezultuan më pak aktive se burrat (64.8%). Ndër meshkujt më pak të përfshirë në aktivitet fizik u identifikuan ata që kishin fëmijë, ishin duhanpirës dhe kishin status shëndetësor të dobët.

Okano, Miyake dhe Mori (2003), në një kompani të madhe në Hokkaido, kanë shqyrtuar marrëdhënien ndërmjet punonjësve të moshës së mesme (50-59 vjeç) dhe aktivitetit fizik në kohën e lirë, duke e krahasuar me vlerësimin subjektiv të shëndetit. Rezultatet treguan se ky vlerësim lidhej ngushtë me aktivitetin fizik në punë dhe në kohën e lirë, si dhe me nivelin e stresit psikologjik.

Leino-Arjas et al. (2004) kanë hulumtuar lidhjen midis ngarkesës në vendin e punës, aktivitetit fizik në kohën e lirë dhe vlerësimit subjektiv të shëndetit fizik. Rezultatet treguan se aktiviteti fizik intensiv redukton ndjeshëm mundësinë e përkeqësimit të shëndetit fizik, veçanërisht në fazat e vona të jetës.

Ali dhe Lindstrom (2006), në një studim të realizuar në Suedi, analizuan kushtet psiko-sociale në punë, aktivitetin fizik në kohën e lirë dhe situatën e të papunëve. Ata konstatuan se meshkujt janë dukshëm më pak të përfshirë në aktivitete fizike në kohën e lirë sesa femrat.

Kouvonen et al. (2005) analizuan lidhjen ndërmjet aktivitetit fizik në kohën e lirë, natyrës së punës dhe ngarkesës së saj te punonjësit e sektorit publik (femra dhe meshkuj). Gjetjet tregojnë se niveli i aktivitetit fizik bie ndjeshëm me rritjen e moshës dhe me rënien e statusit socio-ekonomik.

Schneider dhe Becker (2005) analizuan nivelin e aktivitetit fizik tek popullata e punësuar e moshës së mesme në Gjermani, me fokus tek pjesëmarrja në sport dhe faktorët e punës që e ndikojnë atë. Rezultatet treguan se 39.2% e popullsisë nuk merrnin pjesë në sport, 19% ushtronin të paktën 1 orë në javë, 20.2% ushtronin rregullisht 1-2 orë në javë, ndërsa 13.4% ushtronin 2-4 orë në javë.

Proper et al. (2003) kanë analizuar efektivitetin e programeve të aktivitetit fizik gjatë orarit të punës dhe ndikimin e tyre në shëndetin dhe aftësitë fizike. Sipas rezultateve, ushtrimet fizike gjatë orarit të punës kanë rëndësi të madhe në parandalimin e çrregullimeve muskulo-skeletore.

Thogersen-Ntoumani dhe Fox (2005) kryen një sondazh për të identifikuar lidhjen mes aktivitetit fizik, indeksit të masës trupore (BMI), variablave demografike dhe shëndetit mendor të punonjësve. Rezultatet treguan se mungesa e ushtrimeve fizike dhe e vetëbesimit lidhen me uljen e kënaqësisë në punë.

Nešić et al. (2014), në një mostër prej 450 femrash të moshës mesatare në Novi Sad, analizuan lidhjen midis mënyrës së jetesës dhe përmbajtjes së ushtrimeve rekreative. U konstatua se shumica e grave të moshës së mesme nuk e konsiderojnë aktivitetin fizik si pjesë të rëndësishme të jetës së përditshme. Më pak se 20% ushtrojnë rregullisht (të paktën 3 herë në javë), ndërsa faktorët demografikë, veçanërisht mosha, rezultuan me ndikim statistikisht të rëndësishëm.

Murseli & Gjuraj (2015) theksojnë se sporti dhe aktiviteti fizik në përgjithësi, janë faktorë që kanë një ndikim pozitiv në cilësinë e jetës, shëndet, mendor, stabilitetin mendor, motivimin dhe vetëbesimin si tek personat e të gjitha moshave dhe dy gjinive te popullata ku ajo jeton. Ushtrimet e përgjithshme kanë për qëllim të aktivizojnë gjithë organizmin, për të ndihmuar ruajtjen e statusit shëndetësor në përgjithësi ose të rivendos gjendjen e sëmurë në një gjendje relativisht të shëndetshme. Për realizimin e qëllimit është është popullata nga e cila është nxjerrur mostra e entitetit e cila është definuar si popullatë e personave nga komuna e Prishtinës. Me metoden e mostrës së rastësishme është përzgjedhur mostra e të anketuarve për

qëllimet e këtij hulumtimi. Në hulumtim janë përfshirë – gjithësejt 500 të anketuar të ndarë sipas gjinisë dhe në 5 grupe sipas moshës. Rezultatet e fituara tregojnë se janë fituar dallime të rëndësishme statistikore në mes femrave dhe meshkujve gati në të gjitha pyetjet e shtatë pyetjeve të parashtruara. Gjithashtu rezultatet e fituara tregojnë se janë fituar dallime të rëndësishme statistikore në mes meshkujve të ndarë sipas moshës dhe femrave të ndarë sipas moshës gati në të gjitha pyetjet e shtatë pyetjeve të parashtruara.

Kaçiu dhe Daci (2018), në një studim mbi nxënësit e shkollave të mesme të Podujevës dhe Pejës (mosha 16-17 vjeç), analizuan ndikimin e stilit të jetesës dhe aktiviteteve rekreative fizike në Indeks të Masës Trupore (BMI). Studimi përfshiu 400 nxënës (200 për komunë, nga të dy gjinitë). U përdor një pyetësor i modifikuar që analizoi pjesëmarrjen në aktivitete fizike dhe shprehjet e jetesës si: pirja e duhanit, konsumimi i alkoolit, ushqimi dhe gjumi i rregullt. U përfshinë gjithashtu të dhëna mbi lartësinë dhe peshën trupore për të llogaritur BMI-në. Rezultatet treguan se BMI nuk lidhet drejtpërdrejt me aktivitetet fizike apo shprehjet e jetesës, por më tepër me konsumin e energjisë dhe kohëzgjatjen e aktiviteteve.

Metushi & Muqa (2019) si qëllim të punimit kishin prezantimin e marrjes me aktivitet rekreativ sportiv si dhe kohës më të preferuar për pjesëmarrje me aktivitete rekreative sportive. Hulumtimi i cili është realizuar ka për qëllim para se gjithash, identifikimin e disa shprehjeve të jetesës të nxënësve të Suharekës dhe Ferizajit të cilat mund të kenë ndikim në përcaktimin e mbështetjes në aktiviteteve rekreative sportive në qytetet e trajtuara në punim. Për realizimin e qëllimit Mostra e anketuar në këtë punim është definuar si mostër e përbër nga nxënësit e moshës 16, 17 dhe 18 vjeçe të shkollave të mesme të qytetit të Suharekës dhe Ferizajit. Mostra në përgjithësi ka përfshi në këtë punim 200 nxënës të anketuar të dy komunave të Kosovës nga 100 nxënës të secilës komunë të të dy gjinive. Në grupin e të anketuarve përfshihen nxënës të klasave X, XI dhe XII /domethënë nga 50 nxënës të gjinisë mashkullore dhe 50 nxënës të gjinisë femrore të secilës komunë. Rezultatet e fituara pas përpunimit tregojnë se të anketuarit të ndarë sipas gjinisë dhe vendbanimeve kanë dhënë përgjigje të ndryshme. Egzistojnë dallime të rëndësishme statistikore në mes grupeve të nxënësve të ndarë sipas gjinisë dhe vendbanimeve në Peshën trupore. Egzistojnë dallime të rëndësishme statistikore në mes grupeve të nxënësve të ndarë sipas gjinisë dhe vendbanimeve në Lartësinë trupore. Egzistojnë dallime të rëndësishme statistikore në mes grupeve të nxënësve të ndarë sipas gjinisë dhe vendbanimeve në Indeks të masës trupore (BMI). Egzistojnë dallime të rëndësishme statistikore në mes grupeve të nxënësve

të ndarë sipas gjinisë dhe vendbanimeve në marrjes me aktivitet rekreativ sportiv si dhe kohës më të preferuar për pjesmarrje me aktivitete rekreative sportive. Egzistojnë dallime të rëndësishme statistikor në mes grupeve të nxënësve të ndarë sipas gjinisë dhe vendbanimeve në shprehive të jeteses.

Kurshumlija & Hoxha (2019) theksojn se aktiviteti fizik te femrat e moshes së mesme është një faktor i rëndësishëm për çdo femer që i përket këtij grupi. Femrat që janë më aktive fizikisht janë në gjendje më të mirë shëndetësore. Qëllim kryesor i këtij punimi është paraqitja e nivelit të marrjes me aktivitete rekreativo-sportive, llojet e aktiviteteve, kohës më të preferuar për pjesmarrje me këto aktivitete, tek gratë e dy qyteteve Prishtinë dhe Mitrovicë nga mosha 20-29 vjeçare 30-39 vjeçare dhe 40-50 vjeçare. Mostra e hulumtimit është përbër nga grupi i femrave të dy qyteteve të Kosoves (Prishtinës dhe Mitrovicës). Mostra e të anketuarve ka përfshirë 200 femra që janë përzgjedh rastësisht në këtyre dy komunave. Mostra e të anketuarve në aspektin e kategorive të moshës është ndarë në gjashtë nëngrupe. Grupin e parë dhe të dytë e kanë përbërë femrat e moshës 20-29 vjeçe nga Komuna e Prishtinës dhe Mitrovicës. Grupin e tretë dhe të katërt e kanë përbërë femrat e moshës 30-39 vjeçe nga Komuna e Prishtinës dhe Mitrovicës. Grupin e pestë dhe të gjashtë e kanë përbërë femrat e moshës 40-50 vjeçe nga Komuna e Prishtinës dhe Mitrovicës. Si instrument i hulumtimit është aplikuar pyetësori, i përpiluar dhe modifikuar për këtë hulumtim me 15 pyetje: Qe sa kohë mereni me fitness (KMAF), Sa here në javë ushtroni fitness (HJUSH), Arsyeja e marrjes me fitnes (ARMF), Çka ju motivon për të ushtruar (ÇMOTUSH), Sa kohë ushtroni (SAKOUSH), Cilin aktivitet apo ushtrim e përdorni më së tepërmi (CIAKUPSH), Përgjigjet nga pyetësorët: A përdorni protein (PPROT) dhe Në çfar kohe ushtroni (ÇFKOUSH), A ushtroni për gara (USHGA), A ushtroni për shëndet dhe mirëqenie (USHSH), A e përdorëni fitnesin si rekreacion (PALR), A mendoni se fitnesi ndikon pozitivisht në gjendjen e juaj shëndetësore (MFNPGJSH), Si mund të përshkruani nivelin tuaj të fitnesit (MPNTF), Si ushtroni (SIUSH), Deri në çfar shu me parash jeni të gatshme ta paguani trajnerin personal (PARAT). Nga hapësira e e statistikes komparative (krahasuese) për grupet e mostrave të pavarura do të përdoret procedura diskriminative, para se gjithash, analiza diskriminative në mes të gjitha grupeve ANOVA dhe në mes çdo grupi sipas Post-Hoc analizës LSD. Dallimi në mes grupeve do të bëhet me anë të analizës. Joparametrike Hi-kateror testit. Rezultatet e fituara tregojn se aplikimi i dy teknikave (parametrike dhe joparemetrike) tregon se teknika joparametrike është një formë e përpunimit të rezultateve më e sakt për identifikimin e

grupeve. Rezultatet e fituara tregojn se në mes grupeve të moshës 20-29 vjeç; 30-39 vjeç dhe 40-50 vjeç nga Prishtina dhe 20-29 vjeç; 30-39 vjeç dhe 40-50 vjeç nga Mitrovica ekziston një dallim i rëndësishëm statistikor. Mund të theksojm se femrat e moshave të ndryshme kanë qasje të ndryshme ndaj aktiviteteve fizike rekreative. I përshtaten mundësive të tyre kondicionale, financionale dhe kohore.

Abdiu (2019) si qëllim të këtij hulumtimi kishte që të vërtetoj arsyen se pse popullata e moshës mbi 25 vjeçe e Komunës së Tetovës dëshiron të merret me aktivitete fizike rekreative. Në këtë punim mostraka përfshir 200përsona të moshave nga 25 deri 60 vjeç të cilët merren së paku dy herë në ditë me aktivitete fizike rekreative. Grupin e kanë përbërë 4 nëngrupe me nga 50 përsona: 50 persona te gjinisë mashkullore të moshës 25-39 vjeç; 50 persona te gjinisë femrore të moshës 25-39 vjeç; 50 persona te gjinisë mashkullore të moshës 40-60 vjeç;50 persona te gjinisë femrore të moshës 40-60 vjeç. Pyetësorin se cilat forma të aktiviteteve fizike i pëlqejnë dhe si ndikojnë është plotësuar në qendrat rekreative të Komunës së Tetovës. Personat e përfshirë në anketim me dëshirë kanë pranuar të jenë pjesë e këtij hulumtimi. Për realizimin e qëllimit të këtij punimi është aplikuar pyetësori me 34 pyetje. Të anketuarit dhe të anketuarat mendojnë se aktiviteti fizik ka shumë efekte përfituese në drejtim të shëndetit, pavarësisht nga mosha. Përsonat të cilët kanë një stiltë jetesës të shëndetshëm dhe që rregullisht përfshihen në ushtrime, kanë me pak mundësi të zhvillojnë sëmundje kronike, duke përmendur këtu diabetin, sëmundjet kardio-vaskulare, dhe sëmundjet mendore si dhe forcimin e muskujve dhe socializimin.

Metushi & Muqa (2019) si qëllim të punimit kishin prezantimin e marrjes me aktivitet rekreativ sportiv si dhe kohës më te preferuar për pjesmarrje me aktivitete rekreative sportive. Hulumtimi i cili është realizuar ka për qëllim para se gjithash, identifikimin e disa shprehive të jeteses të nxënësve të Suharekës dhe Ferizajit të cilat mundë të kenë ndikim në përcaktimin e mbështetjes në aktiviteteve rekreative sportive në qytetet e trajtuara në punim. Për realizimin e qëllimit Mostra e anketuar në këtë punim është definuar si mostër e përbër nga nxënësit e moshës 16, 17 dhe 18 vjeçe të shkollave të mesme të qytetit të Suharekës dhe Ferizajit. Mostra në përgjithsi ka përfshi në këtë punim 200 nxënës të anketuar të dy komunave tëKosovës nga 100 nxënës të secilës komunë të të dy gjinive. Në grupin e të anketuarve përfshihen nxënës të klasave X, XI dhe XII /domethënë nga 50 nxënës të gjinisë mashkullore dhe 50 nxënës të gjinisë femrore të secilës komunë. Rezultatet e fituara pas përpunimit tregojnë se të anketuarit të

ndarë sipas gjinisë dhe vendbanimeve kanë dhënë përgjigje të ndryshme. Egzistojnë dallime të rëndësishme statistikore në mes grupeve të nxënësve të ndarë sipas gjinisë dhe vendbanimeve në Peshën trupore. Egzistojnë dallime të rëndësishme statistikore në mes grupeve të nxënësve të ndarë sipas gjinisë dhe vendbanimeve në Lartësinë trupore. Egzistojnë dallime të rëndësishme statistikore në mes grupeve të nxënësve të ndarë sipas gjinisë dhe vendbanimeve në Indeks të masës trupore (BMI). Egzistojnë dallime të rëndësishme statistikore në mes grupeve të nxënësve të ndarë sipas gjinisë dhe vendbanimeve në marrjes me aktivitet rekreativ sportiv si dhe kohës më të preferuar për pjesëmarrje me aktivitete rekreative sportive. Egzistojnë dallime të rëndësishme statistikore në mes grupeve të nxënësve të ndarë sipas gjinisë dhe vendbanimeve në shprehive të jetesës.

Salihu (2021) si qëllim kishte të vërtetohet nivelin e qëndrimit ndaj aktivitetit fizik dhe fakti se sa është ngritur vetëdija e nxënësve të ndarë sipas gjinisë dhe komunave ndaj aktivitetit fizik, konkretisht për tu marrur me aktivitet fizik. Në kuadër të këtij qëllimi primar, parashirohen edhe këto qëllime: a) Të përcaktohet qëndrimi ndaj aktivitetit fizik (sportiv) të maturanëve, b) Të përcaktohet qëndrimi ndaj aktivitetit fizik (sportiv) të maturanëve femra, c) Dallimi në mes maturanëve dhe maturanëve në qëndrimin ndaj aktivitetit fizik, d) Qëndrimi ndaj aktivitetit fizik (sportiv) midis nxënësve të shkollave të ndryshme. Zgjedhja e mostrës ka qenë, para së gjithash, e kushtëzuar me mundësitë ekonomike dhe organizative të matjes. Mostra do të përfshijë 120 maturanë, domethënë 30 maturanë dhe 30 maturanë nga komuna e Ferizajt dhe 30 maturanë dhe 30 maturanë nga komuna e Prishtinës. Për realizimin e këtij punimi janë aplikuar disa variabla në formë të pyetësorit të cilat do të plotësohen nga anketa e parashtruar. Për fitimin e informatave të cilat kanë të bëjnë me qëndrimet e maturanëve dhe maturanëve ndaj aktivitetit fizik (sportiv) do të përdoret inventari i Kneerov-it, i cili është i formuar prej 24 itemave dhe i takon shkallës së llojit të Likertit (me saktësisht-skemë pesëshkallore të llojit të Likertit). Në pyetësor janë 12 pyetje, pozitivisht e parashtruara ndërsa 12 pyetje janë parashtruar negativisht (Ryan, Fredrick, Lepes, Rubio dhe Sheldon 1997). Rezultatet e fituara tregojnë se janë fituar dallime të rëndësishme statistikore $p < 0.05$ në mesataret aritmetikore në mes grupeve të maturanëve neshkuj nga Prishtina (P1-24PM), maturanëve nga Prishtina (P1-24PF), maturanëve neshkuj nga Ferizaji (P1-24FM), maturanëve nga Ferizaji (P1-24FF), të pyetjet: 4. Koha e cila nevojitet për nxemje, lojë apo përgatitje do të ishte më e mirë të shfrytëzohej për dikë tjetër?, 13. Trajnimi sportiv nuk jep asgjë që do të ishte e dobishme jashtë sportit?,

3. SUBJEKTI, PROBLEMI DHE QËLLIMI I HULUMTIMIT

Formimi i qëndrimeve pozitive dhe mendimeve të nxënësve ndaj edukatës fizike është një nga detyrat dhe vlerat e përhershme që duhet të arrihen përmes punës mësimore në edukatën fizike.

Subjekti i këtij hulumtimi është analiza e aktiviteteve të rinisë së Komunës së Pejës gjatë kohës së lirë.

Problemi i këtij hulumtimi, sidomos kur bëhet fjalë për Komunën e Pejës, është mungesa e të dhënave statistikore mbi aktivitetin fizik dhe angazhimin në sport të nxënësve të shkollave të mesme të ulëta në Komunën e Pejës. Ky problem nuk është i kufizuar vetëm për popullatën shkollore, por në të gjitha nivelet ka një problem të madh me mungesën e të dhënave të këtij lloji. Mungesa e këtyre rezultateve çon gjithashtu në probleme në marrjen e vendimeve strategjike në Komunën e Pejës dhe Kosovë, duke ndikuar gjithashtu në ofrimin e rekomandimeve të qarta teorike.

Pikërisht, qëllimi i këtij hulumtimi është të shqyrtojë dhe të përcaktojë nëse nxënësit e klasës VIII të shkollave të mesme të ulëta, të Komunës së Pejës, ndryshojnë në mes atyre nga viset rurale dhe urbane në: masat antropometrike: lartësia trupore, pesha trupore dhe BMI duke i përfshirë edhe; qëndrimet dhe angazhimin në aktivitet fizik dhe sportiv, si dhe vlerësimet subjektive të nxënësve për rëndësinë e aktivitetit fizik dhe pajisjet e sallave për këto aktivitete.

Gjithashtu të hulumtohet niveli, llojet dhe ndikimi i aktiviteteve fizike që ndjekin të rinjtë e Komunës së Pejës gjatë kohës së lirë, si dhe të identifikohen faktorët që i inkurajojnë apo pengojnë ata në përfshirjen në aktivitete të tilla.

Ky qëllim mund të shtrihet në disa objektiva specifike si:

- Të vërtetohet dallimi në mes djemëve nga viset rurale me ata nga viset urbane.
- Të vërtetohet dallimi në mes vajzave nga viset rurale me ata nga viset urbane.
- Të vërtetohet dallimi në mes djemve dhe vajzave katër grupeve rreth qëndrimeve dhe angazhimit të tyre në aktivitet fizik dhe sportiv.
- Të vërtetohet dallimi në mes katër grupeve rreth vlerësimeve subjektive të nxënësve për rëndësinë e aktivitetit fizik dhe pajisjet e sallave për këto aktivitete.
- Të identifikohet se cilat janë aktivitetet fizike më të zakonshme që praktikohen.

4. HIPOTEZA E PUNIMIT

Gjatë planifikimit dhe hartimit të punimit janë vendosur hipoteza për qëllim të analizës krahasuese të grupeve të vëzhguara sipas disa variablave.

H1: Pritet të ketë dallim të rëndësishëm statistikor në mes djemëve nga qyteti, dhe djemëve nga fshati, vajzave nga qyteti dhe vajzave nga fshati në Indeksin e masës trupore.

H2: Pritet të ketë dallim të rëndësishëm statistikor në mes djemëve nga qyteti, dhe djemëve nga fshati, vajzave nga qyteti dhe vajzave nga fshati lidhur me marrjen me aktivitete fizike rekreative.

H3: Pritet të ketë dallim të rëndësishëm statistikor në mes djemëve nga qyteti, dhe djemëve nga fshati, vajzave nga qyteti dhe vajzave nga fshati rreth vlerësimit subjektiv të tyre mbi kushtet e zhvillimit normal të orëve të edukatës fizike

Përmes përpunimit statistik të të dhënave, analiza e të dhënave të marra gjatë punimit do t'i përgjigjet të tri hipotezave, të cilat do të paraqesin bazën kryesore për nxjerrjen e konkluzioneve të punimit.

5. METODOLLOGJIA E HULUMTIMIT

5.1. Rrjedha dhe procedurat e hulumtimit

Sipas orientimit kohor, ky ishte një hulumtim transversal me qëllim të përcaktimit nëse ka vetëdije te popullata shkollore për rëndësinë e lëvizjes dhe aktivitetit fizik, nëse ata angazhohen në aktivitete sportive ose rekreative gjatë kohës së lirë ose a është e mjaftueshme sasia e ushtrimeve në mësim, si dhe kënaqësia e tyre me kushtet aktuale për të marrë pjesë në aktivitete fizike ose sportive në shkollat e tyre.

Të dhënat do të sigurohen përmes një hulumtimi në terren. Pyetëtori përbëhej nga tre pjesë. Pjesa e parë përfshinte karakteristikat demografike të pjesëmarrësve, së bashku me karakteristikat antropometrike të tyre, e dyta përfshinte aktivitetin fizik dhe sportiv, dhe pjesa e tretë lidhej me vlerësimin subjektiv të nxënësve për rëndësinë e aktivitetit fizik dhe pajisjet e sallave për këto aktivitete. Metoda që do të përdoret në këtë hulumtim është metodë e drejtpërdrejtë e hulumtimit në terren për mbledhjen e pyetësorëve. Masat, përkatësisht mbledhja e të dhënave, për qëllimet e këtij hulumtimi do të realizohen gjatë muajit maj 2025. Matësit do të jenë mësues të edukatës fizike dhe studentë të studimeve master me përvojë të mëparshme në testimin e pjesëmarrësve.

5.2 Mostra e të anketuarve

Hulumtimi do të përfshij të intervistuar nga Komuna e Pejës (8 shkolla të arsimit të mesëm të ulët), të cilët janë nxënës të klasëve të VIII (teta). Mostra do të përfshij 200 nxënës të intervistuar (50 djem dhe 50 vajza nga viset urbane si dhe 50 djem dhe 50 vajza nga viset rurale. Mostra përfshin një numër të barabartë djemsh dhe vajzash që ndjekin klasët e teta në shkollat e mesme të ulëta.

5.3 Mostra e instrumenteve të matjes

Mostra e variablave përbëhet nga pyetjet e nxjerura nga anketa (Tatar, 2014):

Pjesa I e pyetësorit – Dy masa morfologjike (lartësia trupore dhe pesha trupore) përmes të cilave llogaritet BMI, si dhe katër pyetje që lidhen me: gjininë, vitin e lindjes, klasën dhe viset e banimit.

Masat morfologjike:

- Lartësia trupore
- Pesha trupore
- BMI

Pjesa II e pyetësorit – Variablat mbi bazën e pyetësorit për vlerësimin e aktivitetit fizik:

1. P1MAF – A merreni me aktivitet fizik? Pyetje e mbyllur, përgjigjet: Po / Jo. Vlerësim subjektiv nga nxënësi.
2. P2ANMAF – Arsyeja përse merresh me aktivitet fizik? Pyetje e mbyllur: Dukje, shëndet, humbje peshe, shoqërim.
3. P3ASHMAF – Sa shpesh merresh me aktivitet fizik? Pyetje e mbyllur, për ata që janë përgjigjur "Po" Përgjigjet: Çdo ditë, 2-3 herë në javë, 1 herë në javë, Më pak se 1 herë në javë.
4. P4AMNS – A merresh me ndonjë sport? Pyetje e mbyllur, përgjigjet: Po / Jo. Vlerësim subjektiv nga nxënësi.
5. P5BSRAZ – Trego arsyet përse nuk merresh me sport: Pyetja e mbyllur, përgjigjen: Mungesa e financave, larg terrenet sportive, skam kohe për mesim.
6. P6SSHMS – Sa shpesh merresh me sport: Pyetje e mbyllur për ata që janë përgjigjur "Po". Përgjigjet: Çdo ditë, 2-3 herë në javë, 1 herë në javë, Më pak se 1 herë në javë.
7. P7MMS – Në ç'mënyrë merresh me sport? Pyetje e mbyllur. Përgjigjet: Si anëtar i një klubi sportiv, si anëtar i një seksioni shkollor, rekreativisht.
8. P8KOJSP – Me cilin sport merresh? Pyetje gjysmë e mbyllur. Përgjigjet: Futboll, Basketboll, Volejboll, Karate, Hendboll dhe Tjetër (nxënësi shkruan sportin tjetër).
9. P10CANMS – Cilat janë arsyet që nuk merresh me atë sport? Pyetje e hapur, nxënësi e shkruan vetë përgjigjen.
10. P11AKSHSPEF – A ka shkolla salla të pajisura për edukatë fizike? Pyetje e mbyllur, përgjigje: Po / Jo. Vlerësim subjektiv.

Pjesa III e pyetësorit – Vlerësimi subjektiv i nxënësve: Nxënësi vlerëson deklaratat e dhëna në një shkallë (sipas Likertit) nga 1 deri në 5, ku 1 – nuk pajtohem fare, dhe 5 – pajtohem plotësisht.

P1	Shumë kënaqem në orët e edukatës fizike	Nuk pajtohem fare	Nuk pajtohem	As pajtohem, as kundërshtoj	Pajtohem	Pajtohem plotësisht
P2	Përpiqem shumë në orët e edukatës fizike					
P3	Jam i kënaqur me angazhimin tim në orët e edukatës fizike					
P4	Nuk më interesojnë shumë orët e edukatës fizike					
P5	Ndjej tension gjatë orëve të edukatës fizike					
P6	Mendoj se jam mjaft i mirë në edukatë fizike					
P7	Orët e edukatës fizike janë të rëndësishme për shëndetin tim					
P8	Detyrat në edukatë fizike janë shumë të vështira					
P9	Jam i kënaqur me sallën ku mbahen orët e edukatës fizike					

Bazuar në pyetjet nga pyetësi, të dhënat që janë marrë lidhen me: lartësinë, peshën, BMI-në, vlerësimin e kushteve, vlerësimin e angazhimit vetjak në sport, vlerësimin e hapësirës, arsyet e mosangazhimit etj.

Duke marrë parasysh natyrën e problemit që trajton vetë punimi, ka lindur nevoja për një hulumtim që lidhet me shkallën e përfshirjes në aktivitetet fizike të të rinjve në kohën e lirë. Hulumtimi i parë i këtij lloji u zhvillua në territorin e Komunës së Pejës.

Meqenëse tema e hulumtimit është aktiviteti fizik i të rinjve në kohën e lirë, pyetësi i destinuar për nxënës të shkollës fillore u krijua në mënyrë që, përveç të dhënave bazë (masa dhe lartësi trupore), të identifikojë sa më lehtë arsyet e tyre për (mos) bërjen e aktivitetit fizik, si dhe për të marrë informacione rreth aktiviteteve që preferojnë më shpesh në kohën e lirë

5.4. Përshkrimi i matjeve

5.4.1. Përshkrimi i matjeve antropometrike

1. Lartësia e trupit

Përshkrimi i detyrës:

Pajisjet e nevojshme për matje: Antropometri

Pozita fillestare: Lartësia e trupit është matë me antropometër, subjekti që është matë ka qenë e zbathur, në veshje sportive dhe ka qëndruar në bazamentin e fortë horizontal të antropometrit. Koka e tij ka qenë në atë pozitë që skaji i poshtëm i syrit dhe skaji i epërm i zgavrës së jashtme të veshit të jenë në pozitë horizontale (horizontalja e Frankfurtit). Qëndrimi i trupit të subjektit ka qenë më e relaksuar dhe i drejtë, shputat e bashkuara, ndërkaq matësi ka qëndruar në të majtë të entitetit.

Realizimi i detyrës: Pasi që e kontrollon pozitën e subjektit dhe të instrumentit (antropometri), matësi e lëshon krahun horizontal të antropometrit deri në pjesën e epërme të kokës (pika më e lartë e kokës – vertex) dhe e lexon në shtyllën e antropometrit pikën e lartësisë.

Vlerësimi: Matet lartësia e trupit në drejtqëndrim e shprehur në milimetra.

Foto 1. Matja e lartësisë së trupit



2. Pesha e trupit

Përshkrimi i detyrës:


Pajisjet e nevojshme për matje: Peshorja

Pozita fillestare: Pesha e trupit matet me peshorën antropometrike, e cila mundëson saktësinë e matjes prej 0.1 kg, treguesi rregullohet në pozitën zero. E domosdoshme është që peshorja të vihet në pozitë horizontale dhe në bazament të fortë.

Realizimi i detyrës: Subjekti është e zbathur në përgatitje të lehta sportive, qëndron e qetë në këmbë, në mes të peshorës. Pasi të qetësohet boshti (treguesi) i peshorës në pozitën ekuilibruese lexohet rezultati. Leximi i rezultatit bëhet me saktësi 0.1 kg.

Vlerësimi: Matet pesha e trupit në drejtpërdrejtë dhe shprehur në 0.1 kg.

Foto 2. Matja e peshës së trupit



3. Indeks i masës trupore – AIMTR

Përshkrimi i detyrës:

Pajisjet e nevojshme për matje: Antropometri, Peshorja

Pozita fillestare: Indeks i masës trupore (Body Mass Index-BMI), është një metodë e llogaritjes së të ushqyerit. Indeks i masës trupore llogaritet shumë thjeshtë, dhe bazohet në bazë të të peshës së trupit dhe lartësisë së trupit.

Realizimi i detyrës: Indeks i masës trupore (BMI – body mass index) është matja – raporti në mes peshës trupore relative dhe gjatësisë trupore në katror, zakonisht është përdorur si formula më e mirë për klasifikuar nënpeshën, mbipeshën dhe trashjen (obezitetin) te burrat dhe gratë.

Vlerësimi: Pra raporti mes peshës në kg dhe lartësisë në m² na jep BMI-në. Kjo llogaritet duke përdorur një formulë shumë të thjeshtë: Peshë (kg)/lartësia (m²) = IMT ose BMI; nëse volejbolistja ka peshën 65 kg dhe lartësinë e trupit 1.70 m

$$\text{Shembull: BMI} = 65 \text{ Kg} / (1.70 \times 1.70) = 65 / 2.89 = 22.49$$

Foto 3. Indeks i masës trupore



5.5. Përpunimi statistikor i të dhënave

Për përpunimin e të dhënave do të përdoret programi softuerik SPSS, i cili është një softuer statistik i njohur ndërkombëtarisht dhe që përdoret në masë të madhe për lloje të tilla kërkimesh. Është shumë e rëndësishme të theksohet se përpunimi i të dhënave do të bëhet si në mënyrë të përmbledhur, ashtu edhe sipas gjinisë dhe viseve. Si të tilla, të gjitha të dhënat na japin mundësi për krahasim rajonal dhe të tjera për nxënësit e klasës së VIII në Komunën e Pejës. Përpunimi i plotë statistikor i të dhënave do të përfshinte: Statistikën bazë, Frekuencën + Përqindjen; Analizën regressive; Testin U i Mann – Whitney; t-testin; Testin Kruskal-Wallis; Analizën e t-testit.

Për të dhënat e nevojshme për përcaktimin e gjendjes sipas përgjigjeve të marra nga anketimi, sipas gjinisë dhe rajonit të të anketuarve, do të përdoren statistika përshkruese (e paraqitur përmes frekuencës dhe përqindjeve, ndërsa për gjatësinë trupore, peshën trupore dhe BMI-në e përfuar do të përdoren parametrat bazë statistikorë).

Përcaktimi i dallimeve mes dy grupeve sipas gjinisë është bërë me testin U i Mann – Whitney në këto kombinime:

- të gjithë djemtë dhe vajzat nga dy rajonet;

Përcaktimin e dallimeve në mesataret aritmetikore mes 4 grupeve sipas gjinisë dhe rajoneve është përdorur analiza Kruskal-Wallis për grupe të pavarura.

Për të përcaktuar mes cilave grupe rajonale ekziston dallim në mesataret aritmetikore është përdorur T-testi për grupe të pavarura.

6. INTERPRETIMI DHE DISKUTIMI

6.1. Parametrat statistikor themelor

6.1.1. Parametrat statistikor të ndryshoreve antropometrike te djemt dhe vajzat të viseve urbane dhe rurale

Brenda grupeve, të gjitha tregojnë shpërndarje statistikisht të rëndësishme (χ^2 , $P < 0.05$), me përjashtim të krahasimeve ndërmjet grupeve të një gjinie. Futboli është sporti dominues për djemtë, veçanërisht ruralët. Volejboli dhe sportet luftarake janë më të pëlqyera nga vajzat, me më shumë diversitet në përzgjedhje. Dallimet ndërmjet të katër grupeve janë shumë të rëndësishme, duke reflektuar ndikimin e gjinisë dhe vendbanimit në zgjedhjen e sportit.

**9. Pajisja e shkollave me salla për edukatë fizike sipas gjinisë dhe vendbanimit
(P9AKSHSPEF)**

Tabela 13.

P9AKSHSPEF – A ka shkolla salla të pajisura për edukatë fizike?											
P9	DJEMT					VAJZAT					DV
	NPU	%	NPR	%	GJ	NPU	%	NPR	%	GJ	GJ
Po	37	74	24	48	61	12	24	17	34	29	90
Jo	13	26	26	52	39	38	76	33	66	71	110
Gjithsej	50	100	50	100	100	50	100	50	100	100	200
Hi katror	$\chi^2= 11.5$ df: 1 P= 0.000		$\chi^2= .8$ df: 1 P= 0.777			$\chi^2= 13.5$ df: 1 P=0.000		$\chi^2= 5.1$ df: 1 P= 0.023			
Hi katror	$\chi^2= 7.1;$ df: 1; P= 0.007				$\chi^2= 1.2$ df: 1 P= 0.270						
Hi katror	$\chi^2= 6.4$					df: 3 P= 0.092					

Kjo pyetje trajton perceptimin dhe realitetin e infrastrukturës sportive nëpër shkolla, konkretisht nëse shkollat kanë salla të pajisura për edukatë fizike. Të dhënat janë ndarë sipas gjinisë dhe vendbanimit të nxënësve dhe janë analizuar përmes testit të Hi-katrore (χ^2), me qëllim identifikimin e dallimeve statistikisht të rëndësishme brenda dhe ndërmjet grupeve (Tabela 13).

Djemtë nga zonat urbane (NDPU) - Nga 50 djem urbanë, 37 (74%) deklarojnë se shkolla e tyre ka sallë për edukatë fizike, ndërsa 13 (26%) mendojnë se nuk ka. Hi-katrore: $\chi^2 = 11.5$; df = 1; P = 0.000 Interpretim: Dallimi është shumë domethënës statistikisht, duke sugjeruar se shumica e djemve urbanë kanë akses në salla të pajisura për edukatë fizike. Ky rezultat nuk është i rastësishëm.

Djemtë nga zonat rurale (NDPR) - Në këtë grup, vetëm 24 (48%) pohuan se shkolla ka sallë të tillë, ndërsa 26 (52%) u shprehën negativisht. Hi-katrore: $\chi^2 = 0.8$; df = 1; P = 0.777. Interpretim: Nuk ka dallim të rëndësishëm statistikisht. Përgjigjet janë të shpërndara pothuajse në mënyrë të barabartë, çka tregon se në zonat rurale mungon qartësia ose konsistenca në infrastrukturën sportive në shkolla.

Vajzat nga zonat urbane (NVPU) - Vetëm 12 nga 50 vajza urbane (24%) deklarojnë se shkolla e tyre ka sallë të pajisur, ndërsa shumica (76%) thonë që jo. Hi-katrore: $\chi^2 = 13.5$; df = 1; P = 0.000. Interpretim: Dallimi është shumë i rëndësishëm statistikisht dhe tregon qartë mungesën e infrastrukturës sportive të përshtatshme për vajzat në shkollat urbane. Kjo tregon një mospërputhje të mundshme në qasjen ndaj vajzave dhe djemve edhe brenda të njëjtit mjedis urban.

Vajzat nga zonat rurale (NVPR) - Në këtë grup, 17 vajza (34%) raportuan se ka sallë për edukatë fizike në shkollën e tyre, ndërsa 33 (66%) thonë që nuk ka. Hi-katrore: $\chi^2 = 5.1$; $df = 1$; $P = 0.023$. Interpretim: Ky rezultat është statistikisht i rëndësishëm, që tregon se shumica e vajzave nga zonat rurale nuk kanë akses në salla të pajisura. Ky fakt nënvizon një mospërputhje të rëndësishme në qasjen ndaj edukatës fizike për këtë grup.

Djemtë urbanë dhe djemtë ruralë - Hi-katrore: $\chi^2 = 7.1$; $df = 1$; $P = 0.007$ Interpretim: Dallimi është domethënës statistikisht. Djemtë urbanë kanë akses dukshëm më të mirë në salla të pajisura për edukatë fizike krahasuar me djemtë ruralë.

Vajzat urbane dhe vajzat rurale - Hi-katrore: $\chi^2 = 1.2$; $df = 1$; $P = 0.270$ Interpretim: Nuk ka dallim statistikisht të rëndësishëm ndërmjet vajzave urbane dhe rurale. Të dyja grupet përjetojnë nivel të ulët aksesibiliteti në infrastrukturë sportive, duke treguar se vendbanimi nuk bën diferencë të madhe në këtë rast për vajzat.

Të katër grupet së bashku - Hi-katrore: $\chi^2 = 6.4$; $df = 3$; $P = 0.092$ Interpretim: Dallimi ndërmjet katër grupeve nuk është statistikisht i rëndësishëm në mënyrë të fortë, por është afër kufirit të rëndësisë statistikore ($P \approx 0.05$). Kjo sugjeron se ekziston një tendencë e dallueshme, por jo e mjaftueshme për të deklaruar ndikim të kombinuar të gjinisë dhe vendbanimit në aksesin në sallat e edukatës fizike.

Djemtë urbanë janë grupi me aksesin më të mirë në salla të pajisura për edukatë fizike. Vajzat, si urbane ashtu edhe rurale, raportojnë në mënyrë dominuese mungesën e infrastrukturës së tillë në shkollat e tyre. Dallimet brenda grupeve gjinore janë statistikisht të rëndësishme tek djemtë, ndërsa tek vajzat jo. Kombinimi i gjinisë dhe vendbanimit nuk rezulton të japë dallim shumë të rëndësishëm në analizën e përgjithshme me katër grupe, por tendencat janë të dukshme dhe meritojnë vëmendje në politikat arsimore dhe sportive.

10. Çfarë duhet të ndryshohet në edukatën fizike sipas gjinisë dhe vendbanimit (P10ÇFNDDR)

Tabela 14.

P10ÇFNDDR - Çfarë është e nevojshme të ndryshohet?											
P10	DJEMT					VAJZAT					DV
	NPU	%	NPR	%	GJ	NPU	%	NPR	%	GJ	GJ
Salla e edukatës fizike	8	16	29	58	37	7	14	28	56	35	72
Pajisjet për ushtrime	26	52	13	26	39	23	26	11	22	34	73
Topa	12	24	6	12	18	14	28	7	14	21	39
Profesori	3	6	0	0	3	5	10	1	2	6	9
Tjera	1	2	2	2	3	1	2	3	6	4	7
Gjithsej	50	100	50	100	100	50	100	50	100	100	200
Hi katror	$\chi^2= 39.4$ df: 4 P= 0.000		$\chi^2= 55.0$ df: 4 P= 0.000			$\chi^2= 30.4$ df: 4 P= 0.000		$\chi^2=46.4$ df: 4 P=0.00			
Hi katror	$\chi^2= 21.5;$ df: 4; P= 0.000				$\chi^2= 22.8$ df: 4 P= 0.000						
Hi katror	$\chi^2= 46.1$					df: 12 P= 0.000					

Kjo pyetje trajton perceptimet e të rinjve për përmirësimin e kushteve të edukatës fizike në shkolla. Të anketuarit kanë identifikuar nevoja për përmirësim në aspekte të ndryshme si: salla e edukatës fizike, pajisjet për ushtrime, topat, profesori apo faktorë të tjerë. Të dhënat janë ndarë sipas gjinisë dhe vendbanimit dhe analizuar përmes testit Hi-katrorë (χ^2) për të vlerësuar domethënien statistikore të shpërndarjes së përgjigjeve brenda dhe ndërmjet grupeve.

Djemtë nga zonat urbane (NDPU) - Më shumë se gjysma e djemve urbanë (52%) mendojnë se duhet përmirësuar pajisjet për ushtrime, ndërsa 24% theksojnë mungesën e topave dhe 16% mendojnë se duhet përmirësuar salla e edukatës fizike. Hi-katrorë: $\chi^2 = 39.4$; df = 4; P = 0.000 Interpretim: Shumë domethënëse statistikiisht. Tregon qartë se perceptimi i djemve urbanë për çështjet që duhen përmirësuar nuk është i shpërndarë rastësisht, me fokus të fortë tek pajisjet dhe materialet sportive.

Djemtë nga zonat rurale (NDPR) - Në këtë grup, përparësi ka salla e edukatës fizike (58%), ndjekur nga pajisjet për ushtrime (26%). Të tjerat kanë peshë të ulët. Hi-katrorë: $\chi^2 = 55.0$; df = 4; P = 0.000. Interpretim: Dallimet janë statistikiisht të rëndësishme. Djemtë ruralë

theksojnë më shumë mungesën e sallave, gjë që përputhet me të dhënat e pyetjeve të mëparshme mbi infrastrukturën shkollore.

Vajzat nga zonat urbane (NVPU) - Për vajzat urbane, më shumë se një e katërta (28%) theksojnë mungesën e topave, ndërsa 26% flasin për pajisjet për ushtrime dhe 14% për sallat. Hi-katrore: $\chi^2 = 30.4$; $df = 4$; $P = 0.000$ Interpretim: Shumë domethënëse statistikisht. Ndërsa vajzat nuk fokusohen në një element të vetëm si djemtë, prapë identifikojnë nevojën për përmirësim të mjeteve dhe materialeve bazë për sport.

Vajzat nga zonat rurale (NVPR) - Një numër i madh vajzash rurale (56%) thonë se salla e edukatës fizike është ajo që ka nevojë më shumë për përmirësim. 22% theksojnë pajisjet për ushtrime, dhe pjesa tjetër shpërndahet në kategoritë tjera. Hi-katrore: $\chi^2 = 46.4$; $df = 4$; $P = 0.000$. Interpretim: Dallimet janë shumë domethënëse. Shumica e vajzave rurale i japin përparësi infrastrukturës – sidomos mungesës së sallave – çka përkon me rezultatet nga P9 për mungesën e sallave në shkolla.

Djemtë urbanë vs. djemtë ruralë Hi-katrore: $\chi^2 = 21.5$; $df = 4$; $P = 0.000$. Interpretim: Dallim shumë domethënës statistikisht. Djemtë ruralë fokusohen te mospasja e sallës, ndërsa urbanët te mungesa e pajisjeve dhe topave, çka tregon ndikimin e qartë të vendbanimit në përjetimin e mungesave.

Vajzat urbane vs. vajzat rurale - Hi-katrore: $\chi^2 = 22.8$; $df = 4$; $P = 0.000$. Interpretim: Dallim shumë i rëndësishëm. Vajzat rurale përqendrohen te mungesa e sallave, ndërsa urbanet shpërndajnë vëmendjen mes topave dhe pajisjeve. Diferencat janë të theksuara dhe të vlefshme statistikisht.

Të katër grupet së bashku - Hi-katrore: $\chi^2 = 46.1$; $df = 12$; $P = 0.000$. Interpretim: Dallimet ndërmjet katër grupeve janë shumë të rëndësishme statistikisht. Kombinimi i gjinisë dhe vendbanimit ndikon në mënyrë të theksuar në perceptimin e nevojave për përmirësim të edukatës fizike. Të gjitha grupet kanë treguar shpërndarje domethënëse statistikisht, që do të thotë se secili grup ka perceptime të qarta dhe të ndryshme për prioritetet në përmirësimin e edukatës fizike. Djemtë ruralë dhe vajzat rurale kërkojnë më shumë salla të pajisura, që është edhe rezultat i mungesës aktuale të tyre. Djemtë urbanë theksojnë më shumë pajisjet sportive, ndërsa vajzat urbane përqendrohen te topat dhe pajisjet. Diferencat ndërmjet grupeve janë të forta dhe të rëndësishme, duke reflektuar ndikimin e vendbanimit dhe gjinisë në përvojat dhe pritshmëritë e të rinjve nga edukata fizike.

6.4. Dallimi ndërmjet grupeve

Në vazhdim të këtij kapitulli janë paraqitur dallimet ndërmjet djemve nga viset urbanë (NDPU), djemve nga viset rurale (NDPR), vajzave nga viset urbane (NVPU); 4 - vajzave nga viset rurale (NVPR) me anë të testit joparametrik të Kruskal-Wallis, i cili përdoret për të krahasuar medianet e më shumë se dy grupeve të pavarura.

P1. Shumë kënaqem në orët e edukatës fizike

Tabela 15.

P1. Shumë kënaqem në orët e edukatës fizike			
Ranks			
	X	N	Mean Rank
P1	1.00	50	118.69
	2.00	50	102.57
	3.00	50	91.12
	4.00	50	89.62
	Total	200	
		Chi-Square	8.740
		df	3
		Asymp. Sig.	.033

Legjenda: 1 - djem urbanë (NDPU); 2 - djem ruralë (NDPR);
3 - vajza urbane (NVPU); 4 - vajza rurale (NVPR)

Në këtë pyetje është vlerësuar niveli i kënaqësisë së nxënësve me orët e edukatës fizike, i ndarë sipas gjinisë dhe vendbanimit në katër grupe: djem urbanë, djem ruralë, vajza urbane dhe vajza rurale. Duke qenë se pyetja lidhet me përjetimin subjektiv të kënaqësisë, është përdorur testi jo-parametrik Kruskal-Wallis, që lejon krahasimin e mesatareve të renditjeve midis më shumë se dy grupeve të pavarura (Tabela 15).

Rezultatet tregojnë se djemtë urbanë janë grupi që ka shprehur nivelin më të lartë të kënaqësisë me një renditje mesatare prej 118.69, të pasuar nga djemtë ruralë me një renditje mesatare prej 102.57. Më pas vijnë vajzat urbane, të cilat kanë një renditje mesatare më të ulët (91.12), ndërsa vajzat rurale paraqesin nivelin më të ulët të kënaqësisë në këtë aspekt, me një renditje mesatare prej 89.62.

Për të vlerësuar nëse këto dallime janë statistikisht të rëndësishme, është analizuar rezultati i testit Kruskal-Wallis. Ky test ka dhënë një vlerë $\chi^2 = 8.740$, me 3 shkallë lirie (df), dhe një vlerë $p = 0.033$. Meqë kjo vlerë është më e vogël se pragu kritik i zakonshëm (0.05), rezultati konsiderohet statistikisht domethënës.

Dallimi i konstatuar tregon se kënaqësia në orët e edukatës fizike nuk është e njëjtë për të gjithë nxënësit, por ndikohet nga faktorë si gjinia dhe vendbanimi. Djemtë në përgjithësi janë më të kënaqur se vajzat, ndërsa nxënësit nga zonat urbane paraqiten më të kënaqur krahasuar me ata nga zonat rurale. Këto rezultate mund të lidhen me diferenca në infrastrukturën shkollore, mundësitë për përfshirje në aktivitet fizik jashtë mësimit, si dhe faktorë socialë apo kulturorë që ndikojnë përjetimin e orës së edukatës fizike në mënyra të ndryshme për grupe të ndryshme.

P2 – Përpiqem shumë në orët e edukatës fizike

Tabela 16.

P2. Përpiqem shumë në orët e edukatës fizike			
Ranks			
	X	N	Mean Rank
P2	1.00	50	106.57
	2.00	50	109.61
	3.00	50	96.59
	4.00	50	89.23
	Total	200	
		Chi-Square	4.618
		df	3
		Asymp. Sig.	.202

Legjenda: 1 - djem urbanë (NDPU); 2 - djem ruralë (NDPR);
3 - vajza urbane (NVPU); 4 - vajza rurale (NVPR)

Në këtë pjesë është analizuar niveli i përpjekjes që nxënësit perceptojnë se bëjnë gjatë orëve të edukatës fizike, në varësi të gjinisë dhe vendbanimit. Të dhënat janë ndarë në katër grupe: djem urbanë, djem ruralë, vajza urbane dhe vajza rurale, dhe janë analizuar përmes testit Kruskal-Wallis, që është i përshtatshëm për krahasimin e renditjeve mes më shumë se dy grupeve kur të dhënat janë jo-parametrike.

Rezultatet tregojnë se djemtë ruralë janë ata që raportojnë përpjekjen më të madhe gjatë orës së edukatës fizike, të ndjekur nga djemtë urbanë, me dallim shumë të vogël mes tyre. Vajzat urbane vijnë pas me një nivel mesatar të përpjekjes, ndërsa vajzat rurale janë grupi që shprehet më pak përkushtuar gjatë orëve të edukatës fizike.

Megjithatë, edhe pse renditjet mesatare dallojnë disi midis grupeve, analiza statistikore nuk tregon një dallim të rëndësishëm nga pikëpamja statistikore. Testi Kruskal-Wallis rezultoi me një vlerë $\chi^2 = 4.618$, me 3 shkallë lirie, dhe një vlerë $p = 0.202$. Kjo vlerë është më e madhe se pragu i rëndësisë statistikore prej 0.05, që do të thotë se nuk ka prova të mjaftueshme për të thënë se dallimet mes grupeve janë domethënëse.

Kjo tregon se, në përgjithësi, nxënësit – pavarësisht gjinisë apo vendbanimit – e perceptojnë veten si mjaft të përfshirë dhe përkushtuar gjatë orëve të edukatës fizike. Ndërsa prirjen e ekzistojnë disa ndryshime në mënyrën si e përjetojnë përpjekjen djemtë dhe vajzat, apo nxënësit urbanë dhe ata ruralë, këto ndryshime nuk janë të theksuara dhe nuk tregojnë një pabarazi të qëndrueshme në nivelin e angazhimit.

Përpjekja në edukatën fizike perceptohet në mënyrë relativisht të njëjtë mes grupeve, dhe gjinia apo vendbanimi nuk janë faktorë që ndikojnë në mënyrë të theksuar në këtë aspekt. Nxënësit, në tërësi, tregojnë një përfshirje të krahasueshme dhe angazhim të ngjashëm gjatë orëve të edukatës fizike (Tabela 16).

P3 – Jam i kënaqur me angazhimin tim në orët e edukatës fizike

Tabela 17

P3 Jam i kënaqur me angazhimin tim në orët e edukatës fizike			
Ranks			
	X	N	Mean Rank
P3	1.00	50	101.01
	2.00	50	86.48
	3.00	50	102.66
	4.00	50	111.85
	Total	200	
		Chi-Square	5.617
		df	3
		Asymp. Sig.	.132

Legjenda: 1 - djem urbanë (NDPU); 2 - djem ruralë (NDPR);

3 - vajza urbane (NVPU); 4 - vajza rurale (NVPR)

Kjo pyetje ka synuar të vlerësojë perceptimin e nxënësve lidhur me kënaqësinë personale ndaj angazhimit të tyre në orët e edukatës fizike. Për analizën janë përfshirë katër grupe të dalluara sipas gjinisë dhe vendbanimit: djem urbanë (1), djem ruralë (2), vajza urbane (3) dhe vajza rurale (4).

Rezultatet tregojnë disa ndryshime interesante në mënyrën se si nxënësit e vlerësojnë angazhimin e tyre. Vajzat nga zonat rurale rezultojnë grupi që është më i kënaqur me angazhimin e tyre, me një renditje mesatare prej 111.85. Pas tyre vijjnë vajzat urbane, me një renditje mesatare 102.66, ndjekur nga djemtë urbanë me 101.01. Djemtë ruralë, në këtë rast, shfaqin nivelin më të ulët të kënaqësisë me angazhimin e vet, me një renditje mesatare prej 86.48.

Për të vlerësuar nëse këto dallime janë statistikiisht të rëndësishme, është përdorur testi Kruskal-Wallis, i cili ka rezultuar me një vlerë $\chi^2 = 5.617$, me 3 shkallë lirie (df) dhe një vlerë $p = 0.132$. Meqë kjo vlerë është më e madhe se niveli i rëndësisë statistikore prej 0.05, rezultati nuk konsiderohet domethënës në aspektin statistik.

Ky rezultat tregon se, edhe pse ka disa dallime në mënyrën si nxënësit vlerësojnë kënaqësinë me angazhimin e tyre, këto dallime nuk janë statistikiisht të rëndësishme. Kështu, mund të thuhet se në përgjithësi, nxënësit – pavarësisht gjinisë apo vendbanimit – ndihen mjaftueshëm të kënaqur me angazhimin që tregojnë në orët e edukatës fizike. Interesante është se në këtë rast, vajzat rurale (që në pyetjet e tjera shpesh rezultojnë më pasive ose më pak të përfshira) raportojnë nivelin më të lartë të kënaqësisë personale, që mund të tregojë një lidhje pozitive mes përpjekjes individuale dhe perceptimit personal të vlerës së angazhimit – pavarësisht kushteve të jashtme.

Angazhimi në orët e edukatës fizike perceptohet pozitivisht në të gjitha grupet, pa dallime të theksuara statistikore. Megjithatë, renditjet sugjerojnë se vajzat – veçanërisht ato në zonat rurale – kanë një ndjenjë më të fortë të kënaqësisë ndaj përpjekjes së tyre, krahasuar me djemtë, veçanërisht ata ruralë (Tabela 17).

P4 – Nuk më interesojnë shumë orët e edukatës fizike

Tabela 18.

P4 Nuk më interesojnë shumë orët e edukatës fizike			
Ranks			
	X	N	Mean Rank
P4	1.00	50	91.35
	2.00	50	110.95
	3.00	50	88.07
	4.00	50	111.63
	Total	200	
		Chi-Square	7.882
		df	3
		Asymp. Sig.	.049

Legjenda: 1 - djem urbanë (NDPU); 2 - djem ruralë (NDPR);
3 - vajza urbane (NVPU); 4 - vajza rurale (NVPR),

Kjo pyetje synon të zbulojë nivelin e mosinteresimit të nxënësve për orët e edukatës fizike. Përgjigjet janë krahasuar midis katër grupeve: djem urbanë (1), djem ruralë (2), vajza urbane (3) dhe vajza rurale (4). Përdorimi i testit Kruskal-Wallis mundëson vlerësimin e dallimeve mes këtyre grupeve në mënyrë statistikore, pa supozuar shpërndarje normale të të dhënave.(Tabela 18).

Rezultatet tregojnë një dallim të dukshëm në qëndrimin ndaj edukatës fizike. Djemtë ruralë (110.95) dhe vajzat rurale (111.63) kanë renditjet mesatare më të larta, që nënkupton shkallë më të lartë të mosinteresimit për orët e edukatës fizike në krahasim me grupet e tjera. Në anën tjetër, vajzat urbane (88.07) dhe djemtë urbanë (91.35) kanë renditje më të ulëta, çka sugjeron interes më të madh për këtë lëndë.

Testi Kruskal-Wallis ka rezultuar me $\chi^2 = 7.882$, me 3 shkallë lirie, dhe një vlerë $p = 0.049$. Kjo është shumë afër kufirit të zakonshëm të rëndësisë statistikore ($p = 0.05$), dhe si e tillë konsiderohet statistikisht domethënëse. Kjo do të thotë se dallimet në nivelin e interesimit për edukatën fizike midis grupeve janë të rëndësishme dhe jo të rastësishme.

Rezultatet sugjerojnë se vendbanimi është një faktor ndikues në qëndrimin ndaj edukatës fizike, me nxënësit ruralë (si vajzat, ashtu edhe djemtë) që shfaqin më pak interes për këtë lëndë në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre urbanë. Gjinia, gjithashtu, luan një rol, por

duket se vajzat urbane janë grupi më i interesuar, ndonëse në shumë pyetje të tjera, janë treguar më pasive në angazhim praktik. Kjo mospërputhje mund të interpretohet si rezultat i faktorëve të ndryshëm si: mungesë infrastrukture në zonat rurale, mungesë motivimi nga ana e mësuesve, ose mungesë aktiviteteve fizike cilësore që do ta bënin orën e edukatës fizike më tërheqëse.

Dallimet në interesimin për edukatën fizike janë statistikisht të rëndësishme midis grupeve gjinore dhe gjeografike. Nxënësit urbanë, veçanërisht vajzat, tregojnë më shumë interesim për orët e edukatës fizike, ndërsa nxënësit ruralë – si vajza ashtu edhe djem – raportojnë më shumë mosinteresim, çka kërkon vëmendje të veçantë nga institucionet arsimore dhe politikat e barazisë në edukim fizik.

P5 – Ndjej tension gjatë orëve të edukatës fizike

Tabela 19.

P5 Ndjej tension gjatë orëve të edukatës fizike			
Ranks			
	X	N	Mean Rank
P5	1.00	50	111.05
	2.00	50	104.20
	3.00	50	87.00
	4.00	50	99.75
	Total	200	
		Chi-Square	5.468
		df	3
		Asymp. Sig.	.141

Legjenda: 1 - djem urbanë (NDPU); 2 - djem ruralë (NDPR);
3 - vajza urbane (NVPU); 4 - vajza rurale (NVPR)

Kjo pyetje ka synuar të vlerësojë ndjenjën e tensionit apo stresit që nxënësit përjetojnë gjatë orëve të edukatës fizike. Ndjenja e tensionit mund të jetë tregues i faktorëve si: presioni për performancë, mungesa e vetëbesimit, apo ndonjë përjetim negativ gjatë aktiviteteve fizike në shkollë (Tabela 19).

Nga të dhënat, vihet re se djemtë urbanë kanë renditjen mesatare më të lartë (111.05), çka sugjeron se ata raportojnë nivel më të lartë tensioni krahasuar me grupet e tjera. Pas tyre

vijnë djemtë rurale me një mesatare prej 104.20, dhe vajzat rurale me 99.75. Grupi me më pak ndjenjë tensioni janë vajzat urbane, me një renditje mesatare prej 87.00.

Për të testuar nëse këto ndryshime janë statistikiisht të rëndësishme, është përdorur testi Kruskal-Wallis, i cili ka rezultuar me vlerën $\chi^2 = 5.468$, me 3 shkallë lirie, dhe vlerë $p = 0.141$.

Meqë vlera p është më e madhe se 0.05, kjo nënkupton se nuk ka dallime statistikiisht të rëndësishme mes grupeve sa i përket ndjenjës së tensionit gjatë orëve të edukatës fizike. Pra, edhe pse në pamje të parë djemtë urbanë duken më të tensionuar dhe vajzat urbane më të qeta, këto dallime nuk janë mjaftueshëm të mëdha për të qenë statistikiisht të vlefshme.

Megjithatë, vlen të përmendet se tendenca e djemve urbanë për të ndjerë më shumë tension mund të lidhet me pritshmëri më të larta ndaj tyre për të performuar në sport, apo me konkurrencën brenda klasës. Në anën tjetër, vajzat urbane mund të ndihen më të relaksuara për shkak të përfshirjes më të ulët ose pritshmërive më të lehta.

Ndjenja e tensionit në orët e edukatës fizike varion mes grupeve gjinore dhe gjeografike, me djemtë urbanë që raportojnë më shumë stres dhe vajzat urbane më pak. Megjithatë, këto dallime nuk janë statistikiisht të rëndësishme, sipas testit Kruskal-Wallis, duke treguar se tensioni gjatë orës së edukatës fizike nuk ndikohet në mënyrë të theksuar nga gjinia apo vendbanimi.

P6 – Mendoj se jam mjaft i mirë në edukatë fizike

Tabela 20.

P6 Mendoj se jam mjaft i mirë në edukatë fizike			
Ranks			
	X	N	Mean Rank
P6	1.00	50	120.86
	2.00	50	80.70
	3.00	50	119.85
	4.00	50	80.59
	Total	200	
		Chi-Square	25.659
		df	3
		Asymp. Sig.	.000

Legjenda: 1 - djem urbanë (NDPU); 2 - djem ruralë (NDPR);
3 - vajza urbane (NVPU); 4 - vajza rurale (NVPR)

Kjo pyetje ka për qëllim të matin perceptimin e vetëvlerësimit të nxënësve për aftësitë e tyre në edukatë fizike. Vetëvlerësimi i lartë lidhet shpesh me pjesëmarrje më të madhe në aktivitetet fizike dhe me më shumë vetëbesim në situata sportive (Tabela 20).

Sipas rezultateve, djemtë urbanë (NDPU) kanë renditjen mesatare më të lartë (120.86), që tregon një vetëvlerësim shumë të lartë për aftësitë e tyre në edukatë fizike. Ngjashëm, vajzat urbane (NVPU) kanë gjithashtu një renditje të lartë (119.85), çka sugjeron se edhe ato ndihen mjaft të afta në këtë lëndë.

Në të kundërt, djemtë ruralë (NDPR) dhe vajzat rurale (NVPR) kanë renditje ndjeshëm më të ulëta, përkatësisht 80.70 dhe 80.59, duke treguar një vetëvlerësim më të dobët në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre urbanë.

Analiza statistikore me testin Kruskal-Wallis ka rezultuar me një vlerë shumë domethënëse: $\chi^2 = 25.659$, $df = 3$, $p = 0.000$. Ky rezultat tregon një dallim statistikisht shumë të rëndësishëm mes grupeve lidhur me perceptimin për aftësinë personale në edukatë fizike. Në mënyrë të qartë, nxënësit urbanë, si vajzat ashtu edhe djemtë, e vlerësojnë më shumë veten në këtë lëndë, krahasuar me nxënësit ruralë. Ky ndryshim mund të lidhet me faktorë si:

- infrastruktura më e mirë sportive në zonat urbane,
- mundësi më të shumta për përfshirje në aktivitete sportive jashtë shkollës,
- nivel më i lartë i motivimit dhe mbështetjes në shkolla urbane,
- ose mungesë vetëbesimi te nxënësit nga zonat rurale, ndoshta për shkak të mungesës së kushteve dhe pajisjeve adekuate për ushtrime.

Të dhënat tregojnë qartë se nxënësit urbanë kanë një vetëvlerësim dukshëm më të lartë për aftësitë e tyre në edukatë fizike, krahasuar me nxënësit ruralë. Ky dallim është statistikisht shumë i rëndësishëm ($p = 0.000$), duke theksuar nevojën për ndërhyrje më të madhe në zonat rurale, si në aspektin e infrastrukturës, ashtu edhe në ndërtimin e vetëbesimit dhe motivimit të nxënësve për përfshirje në aktivitete fizike.

P7 – Orët e edukatës fizike janë të rëndësishme për shëndetin tim

Tabela 21.

P7 Orët e edukatës fizike janë të rëndësishme për shëndetin tim			
Ranks			
	X	N	Mean Rank
P7	1.00	50	103.33
	2.00	50	100.23
	3.00	50	98.39
	4.00	50	100.05
	Total	200	
		Chi-Square	.267
		df	3
		Asymp. Sig.	.966

Legjenda: 1 - djem urbanë (NDPU); 2 - djem ruralë (NDPR);
3 - vajza urbane (NVPU); 4 - vajza rurale (NVPR)

Kjo pyetje synon të vlerësojë perceptimin e nxënësve për rëndësinë që kanë orët e edukatës fizike në mirëqenien dhe shëndetin e tyre fizik. Rëndësia që u jepet këtyre orëve mund të reflektojë edhe vlerësimin që bëhet ndaj aktivitetit fizik në jetën e përditshme të nxënësve. Sipas rezultateve, dallimet mes grupeve janë shumë të vogla:

- Djemtë urbanë (NDPU) kanë renditjen mesatare më të lartë me 103.33,
- Ndiqen nga djemtë ruralë (NDPR) me 100.23,
- Vajzat rurale (NVPR) me 100.05, dhe
- Vajzat urbane (NVPU) kanë renditjen më të ulët me 98.39.

Kjo pyetje synon të vlerësojë perceptimin e nxënësve për rëndësinë që kanë orët e edukatës fizike në mirëqenien dhe shëndetin e tyre fizik. Rëndësia që u jepet këtyre orëve mund të reflektojë edhe vlerësimin që bëhet ndaj aktivitetit fizik në jetën e përditshme të nxënësve. Sipas rezultateve, dallimet mes grupeve janë shumë të vogla:

Diferencat janë minimale dhe nuk tregojnë ndonjë prirje të qartë mes gjinive apo vendbanimit. Testi Kruskal-Wallis jep rezultatet: $\chi^2 = 0.267$, $df = 3$, $p = 0.966$.

Duke qenë se vlera p (0.966) është shumë më e madhe se 0.05, mund të konkludohet se nuk ka dallim statistikisht të rëndësishëm në vlerësimin e rëndësisë së orëve të edukatës fizike për shëndetin, ndërmjet katër grupeve të nxënësve. Pavarësisht dallimeve të vogla numerike, të

gjithë nxënësit – pavarësisht nga gjinia apo vendbanimi – e vlerësojnë ngjashëm rëndësinë e edukatës fizike për shëndetin e tyre (Tabela 21).

Rezultatet tregojnë se të gjithë nxënësit, pa dallim gjinie apo vendbanimi, kanë një qëndrim të qëndrueshëm dhe të ngjashëm pozitiv ndaj rëndësisë së orëve të edukatës fizike për shëndetin personal. Dallimet janë statistikisht të parëndësishme ($p = 0.966$), duke sugjeruar se kjo bindje është e përbashkët dhe mjaft e konsoliduar tek të gjithë nxënësit e përfshirë në studim.

P8 – Detyrat në edukatë fizike janë shumë të vështira

Tabela 22.

P8 Detyrat në edukatë fizike janë shumë të vështira			
Ranks			
	X	N	Mean Rank
P8	1.00	50	99.62
	2.00	50	82.84
	3.00	50	99.98
	4.00	50	119.56
	Total	200	
		Chi-Square	10.807
		df	3
		Asymp. Sig.	.013

Legjenda: 1 - djem urbanë (NDPU); 2 - djem ruralë (NDPR);
3 - vajza urbane (NVPU); 4 - vajza rurale (NVPR)

Kjo pyetje ka për qëllim të zbulojë perceptimin e nxënësve për nivelin e vështirësisë së detyrave dhe ushtrimeve në orët e edukatës fizike. Renditja mesatare për secilin grup pasqyron sa i vështirë u duket ky lëndim dhe aktivitetet që përfshin ai (Tabela 22).

Sipas rezultateve:

- Vajzat rurale (NVPR) kanë renditjen mesatare më të lartë (119.56), që tregon se ky grup e percepton në mënyrë më të theksuar vështirësinë e detyrave në edukatë fizike.
- Vajzat urbane (NVPU) gjithashtu kanë një perceptim relativisht të lartë të vështirësisë (99.98), pothuaj sa djemtë urbanë.
- Djemtë urbanë (NDPU) kanë një renditje mesatare 99.62, duke treguar një perceptim të moderuar të vështirësisë.

- Djemtë ruralë (NDPR) e perceptojnë më pak vështirësinë e detyrave në edukatë fizike, me një renditje mesatare më të ulët – 82.84, që është ndjeshëm më e vogël krahasuar me grupet e tjera.

Testi Kruskal-Wallis rezulton me: $\chi^2 = 10.807$, $df = 3$, $p = 0.013$.

Ky rezultat është statistiki i rëndësishëm ($p < 0.05$), çka do të thotë se ekziston një dallim domethënës mes grupeve në perceptimin e tyre për vështirësinë e detyrave në edukatë fizike. Veçanërisht bie në sy:

- vajzat nga zonat rurale janë grupi që e percepton më shumë vështirësi këtë lëndë,
- ndërsa djemtë nga zonat rurale janë më të relaksuar dhe më pak të ndikuar nga kjo ndjesi vështirësie.

Dallimi i theksuar ndërmjet vajzave rurale dhe djemve ruralë sugjeron se faktorë si kushtet fizike, vetëbesimi në aktivitet fizik apo niveli i pritjeve në shkollë mund të ndikojnë ndjeshëm në këtë perceptim. Të dhënat tregojnë një dallim domethënës statistiki ($p = 0.013$) ndërmjet grupeve në lidhje me perceptimin për vështirësinë e detyrave në edukatë fizike. Vajzat rurale ndihen më të ngarkuara dhe e perceptojnë këtë lëndë si më të vështirë, krahasuar me grupet tjera, ndërsa djemtë ruralë ndihen më të lirë nga ky perceptim negativ. Rezultat mund të sinjalizojë nevojën për pranimin më të mirë të dallimeve gjinore dhe rajonale në planifikimin e lëndëve të edukatës fizike dhe përkrahjen ndaj nxënësve që përjetojnë më shumë vështirësi.

P9 – Jam i kënaqur me sallën ku mbahen orët e edukatës fizike

Tabela 23.

P9 Jam i kënaqur me sallën ku mbahen orët e edukatës fizike			
Ranks			
	X	N	Mean Rank
P9	1.00	50	118.39
	2.00	50	89.93
	3.00	50	114.99
	4.00	50	78.69
	Total	200	
		Chi-Square	17.856
		df	3
		Asymp. Sig.	.000

Legjenda: 1 - djem urbanë (NDPU); 2 - djem ruralë (NDPR);
3 - vajza urbane (NVPU); 4 - vajza rurale (NVPR)

Kjo pyetje synon të vlerësojë kënaqësinë e nxënësve me sallat ku zhvillohen orët e edukatës fizike, duke krahasuar perceptimet sipas gjinisë dhe vendbanimit (Tabela 23).

Renditjet mesatare të katër grupeve janë si më poshtë:

- Djemtë urbanë (NDPU) kanë renditjen mesatare më të lartë (118.39), duke shprehur kënaqësinë më të madhe me sallat ku mbahen orët e edukatës fizike.
- Vajzat urbane (NVPU) ndjekin me një renditje shumë të afërt (114.99), çka tregon gjithashtu kënaqësi të lartë, të krahasueshme me djemtë urbanë.
- Djemtë ruralë (NDPR) kanë një renditje mesatare më të ulët (89.93), që tregon kënaqësi të moderuar ose të kufizuar me sallat ku zhvillohen orët.
- Vajzat rurale (NVPR) shfaqin renditjen mesatare më të ulët (78.69), duke treguar kënaqësinë më të ulët ndër të gjitha grupet.

Analiza statistikore: Chi-square (χ^2) = 17.856, df = 3 Asymp. Sig. (P-vlera) = 0.000.

Rezultati është statistikorisht shumë i rëndësishëm ($p < 0.001$), që do të thotë se ekziston një dallim i rëndësishëm në nivelin e kënaqësisë së nxënësve me sallat e edukatës fizike në varësi të gjinisë dhe vendbanimit.

Veçanërisht, mund të vërehet:

- Nxënësit urbanë, si djem ashtu edhe vajza, janë dukshëm më të kënaqur me sallat e tyre – kjo mund të lidhet me infrastrukturë më të mirë, hapësira më moderne apo pajisje më të përshtatshme në shkollat e zonave urbane.
- Nxënësit nga zonat rurale, veçanërisht vajzat, janë më pak të kënaqura – gjë që mund të pasqyrojë mungesën e sallave të pajisura mirë, kushte të papërshtatshme fizike ose akses të kufizuar ndaj burimeve sportive.
- Ekziston një dallim statistikorisht i rëndësishëm ($\chi^2 = 17.856$; $p = 0.000$) ndërmjet grupeve në lidhje me kënaqësinë e tyre për sallat ku zhvillohen orët e edukatës fizike. Djemtë urbanë dhe vajzat urbane janë dukshëm më të kënaqur, ndërsa vajzat rurale raportojnë kënaqësinë më të ulët. Ky dallim thekson pabarazitë infrastrukturore mes shkollave urbane dhe rurale dhe nënvizon nevojën për përmirësime në mjediset sportive, veçanërisht në zonat rurale.

65. Vërtetimi i hipotezave të punimit

Vërtetimi i hipotezave është me sa vijon:

Hipoteza H1 është mbështetur pjesërisht nga të dhënat: ka dallime të rëndësishme statistikisht në mes vajzave nga qyteti dhe fshati në lartësi dhe peshë trupore, por jo në BMI. Për djemtë, nuk janë gjetur dallime të rëndësishme statistikisht në asnjë nga treguesit e analizuar.

Hipoteza H2 është realizuar pjesërisht. Dallimet e rëndësishme statistikisht janë vërejtur në përfshirjen e aktiviteteve fizike rekreative mes djemve urbanë dhe vajzave rurale, duke mbështetur ndikimin e vendbanimit dhe gjinisë në nivelin e aktivitetit fizik.

Hipoteza H3 është realizuar me sukses. Rezultatet e analizës statistikore tregojnë një dallim të rëndësishëm statistikisht në vlerësimin subjektiv të nxënësve mbi kushtet e zhvillimit normal të orëve të edukatës fizike, në varësi të gjinisë dhe vendbanimit.

7. PËRFUNDIM

Ky hulumtim ka synuar të analizojë nivelin e përfshirjes së nxënësve të klasës së VIII nga Komuna e Pejës në aktivitetet fizike dhe qëndrimet e tyre ndaj edukatës fizike, duke marrë për bazë dallimet midis gjinisë dhe vendbanimit (urbane vs. rurale). Qëllimi kryesor ishte të vlerësohen ndryshimet në masat antropometrike (lartësia, pesha dhe BMI), si dhe të analizohen perceptimet dhe praktikrat e nxënësve lidhur me rëndësinë e aktivitetit fizik, kushtet për zhvillimin e tij dhe barrierat e përfshirjes.

Hipotezat e punimit u orientuan drejt vërtetimit të dallimeve statistikisht të rëndësishme ndërmjet grupeve të ndryshme, në mënyrë që të kuptohet më qartë ndikimi i mjedisit jetësor dhe gjinisë në shëndetin dhe aktivitetin fizik të nxënësve. Mostra e përzgjedhur përfshiu 200 nxënës të klasës së VIII nga tetë shkolla të arsimit të mesëm të ulët në Komunën e Pejës, e ndarë në mënyrë të barabartë sipas gjinisë dhe vendbanimit, gjë që siguroi balancë dhe përfaqësim të drejtë në analizë.

Variablat e hulumtuara janë mbledhur përmes një pyetësoi të strukturuar, i cili përfshinte të dhëna morfologjike, të dhëna për qëndrimet ndaj aktivitetit fizik dhe vlerësime subjektive të nxënësve mbi kushtet dhe rëndësinë e edukatës fizike. Përpunimi i të dhënave u realizua përmes programit SPSS, duke përdorur teknika të ndryshme statistikore si: analiza përshkruese, t-testi për grupe të pavarura, testi Mann–Whitney dhe analiza Kruskal-Wallis. Kjo qasje e gjithanshme statistikore ka mundësuar krahasimin mes grupeve dhe identifikimin e dallimeve reale dhe domethënëse në variablat e shqyrtuara.

Rezultatet e këtij hulumtimi dëshmojnë se ekzistojnë disa dallime antropometrike mes nxënësve të klasës VIII në Komunën e Pejës në varësi të gjinisë dhe zonës së banimit, por jo të gjitha janë statistikisht të rëndësishme.

Analiza e parametrave antropometrikë dhe krahasimi i tyre ndërmjet nxënësve dhe nxënësve nga viset urbane dhe rurale në Komunën e Pejës nxjerr në pah disa aspekte të rëndësishme lidhur me ndikimin e mjedisit në zhvillimin fizik të fëmijëve.

Tek djemtë, ndonëse treguesit mesatarë të lartësisë trupore, peshës dhe indeksit të masës trupore (BMI) janë pak më të larta në grupin urban, këto dallime nuk janë statistikisht të rëndësishme. Kjo sugjeron se mjedisi urban apo rural nuk ka ndikim thelbësor në përmasat antropometrike të tyre, duke treguar mundësinë e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe relativisht

uniform në të dyja mjediset, ndoshta për shkak të faktorëve të përbashkët socialë, ekonomikë apo kulturorë.

Nga ana tjetër, tek vajzat dallimet në lartësi dhe peshë trupore midis grupeve urbane dhe rurale janë të dukshme dhe statistikisht domethënëse, me një avantazh në favor të vajzave urbane. Kjo mund të lidhet me kushtet më të favorshme jetësore dhe shëndetësore në zonat urbane, si ushqyerja më e mirë, qasja në kujdesin shëndetësor dhe mundësitë për aktivitet fizik.

Këto gjetje tregojnë se ndikimi i zonës së banimit në zhvillimin antropometrik të nxënësve është më i theksuar tek vajzat sesa tek djemtë dhe se faktorët ambientalë dhe socio-ekonomikë mund të ndikojnë ndryshe në zhvillimin trupor sipas gjinisë. Në përgjithësi, mungesa e dallimeve të thella tek djemtë dhe balanca trupore e vajzave sugjerojnë përpjekje të suksesshme për barazi në kushtet jetësore dhe edukative në Komunën e Pejës, megjithëse ka ende hapësirë për përmirësim, sidomos në zonat rurale

Nga analiza joparametrike u vërtetua se pjesëmarrja në aktivitet fizik ndryshon në bazë të gjinisë dhe vendbanimit. Djemtë urbanë janë më aktivë sesa ata ruralë, ndërsa vajzat rurale janë më pak aktive krahasuar me vajzat urbane. Motivimi për aktivitetin fizik ndryshon sipas grupit, ku djemtë urbanë fokusohen më shumë tek shëndeti, ndërsa vajzat dhe djemtë ruralë te humbja në peshë. Përfshirja në sport është më e madhe tek djemtë, veçanërisht ata urbanë, ndërsa vajzat ruralë kanë përfshirjen më të ulët. Në përgjithësi, gjinia dhe vendbanimi ndikojnë ndjeshëm në aktivitetin fizik dhe motivimin për të.

Në përmbledhje, rezultatet tregojnë se perceptimet dhe përjetimet ndaj edukatës fizike ndryshojnë në varësi të faktorëve të ndryshëm socialë dhe gjeografikë. Grupi me vendbanim urban paraqet shpesh një nivel më të lartë kënaqësie dhe vetëvlerësimi në këtë lëndë, ndërsa grupet rurale shfaqin më shumë sfida, si perceptim më i lartë i vështirësive dhe më pak interesim. Megjithatë, përpjekja dhe angazhimi gjatë orëve të edukatës fizike janë relativisht të njëjta mes grupeve të ndryshme, duke treguar një përkushtim të përbashkët. Ndjenja e tensionit nuk paraqet dallime të theksuara statistikisht, ndërsa rëndësia që u jepet edukatës fizike për shëndetin është e pranuar gjerësisht dhe në mënyrë të barabartë. Këto dallime dhe ngjashmëri nënvizojnë nevojën për politika dhe ndërhyrje që të adresojnë pabarazitë në infrastrukturë dhe motivim, duke siguruar një përvojë më të drejtë dhe të përfshirë për të gjithë në edukatën fizike.

8. RËNDESIDIA TEORIKE DHE PRAKTIKE

Rëndësia teorike:

Ky hulumtim kontribuon në literaturën ekzistuese mbi edukatën fizike duke ofruar një analizë të detajuar të faktorëve që ndikojnë në përfshirjen e nxënësve në aktivitetet fizike. Ai thekson rëndësinë e mjedisit jetësor dhe gjinisë në zhvillimin fizik të fëmijëve, duke ofruar një kuptim më të thellë të ndikimeve të këtyre faktorëve. Për më tepër, hulumtimi ndihmon në identifikimin e barrierave që pengojnë pjesëmarrjen e nxënësve në aktivitetet fizike dhe ofron rekomandime për adresimin e këtyre barrierave, duke kontribuar kështu në zhvillimin e politikave dhe praktikave më efektive në fushën e edukatës fizike.

Rëndësia praktike:

Rezultatet e këtij hulumtimi janë të rëndësishme për zhvillimin e strategjive dhe politikave që synojnë përmirësimin e përfshirjes së nxënësve në aktivitetet fizike. Ato ofrojnë informacione të vlefshme për mësuesit, drejtorët e shkollave dhe politikanët për të kuptuar më mirë nevojat dhe sfidat që hasin nxënësit në lidhje me edukatën fizike. Për më tepër, hulumtimi ndihmon në identifikimin e praktikave më efektive për të rritur motivimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve në aktivitetet fizike, duke kontribuar kështu në përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së tyre.

Përfundim:

Ky hulumtim ofron një kuptim të thellë të faktorëve që ndikojnë në përfshirjen e nxënësve në aktivitetet fizike dhe qëndrimet e tyre ndaj edukatës fizike. Ai kontribon në literaturën ekzistuese dhe ofron rekomandime praktike për përmirësimin e përfshirjes së nxënësve në aktivitetet fizike, duke pasur një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin e politikave dhe praktikave në fushën e edukatës fizike.

9. LITERATURA

Abdiu, V. (2019). Niveli i përfshirjes dhe preferencat e tyre për aktivitete rekreative tek popullata e tetovës Punim i diplomës master. Prishtinë: Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, Universiteti i Prishtines` Hasan Prishtina.

Ali, S. M., & Lindstrom, M. (2006). Leisure time physical activity and psychological well-being among unemployed and employed people: A population-based study in southern Sweden. *Scandinavian Journal of Public Health*, 34(2), 107–113. <https://doi.org/10.1080/14034940510032231>.

Andrijašević, M. (2000.). Slobodno vrijeme i igra. U: Andrijašević (ur.) Zbornik radova –Slobodno vrijeme i igra, str. 7-14. Zagreb: Fakultet za fizičku kulturu Sveučilišta u Zagrebu.

Aarnio, M. E. (2003). Leisure-time physical activity in late adolescence: a cohort study of stability, correlates and familial aggregation in twin boys and girls. *Journal of sports science and medicine*, 2(2), 1-41.

Bouillet, D., Ilišin, V., Potočnik, D. (2008.). Continuity and Changes in Croatian University Students' Leisure Time Activities (1999.–2004.). *Sociologija i prostor*, 46 (2), 123–142.

Burton, N. W., & Turrell, G. (2000). Occupation, hours worked, and leisure-time physical activity. *Preventive Medicine*, 31(6), 673–681. <https://doi.org/10.1006/pmed.2000.0756>

Dumazedier, J. (1972.). Rad i slobodno vrijeme. u: Friedmann G. i Naville P. (ur.) *Sociologija rada*. Sarajevo: Veselin Masleša.

Grandić, R. i Letić M. (2009). Životni stilovi slobodnog vremena mladih u Srbiji. *Pedagoška stvarnost*, vol. 55, br. 5-6, str. 468-478

Havelka, N., Vučić, L., Hrnjica, S., Lazarević, Lj., Kuzmanović, B., Kovačević, P. (1990). *Obrazovna i razvojna postignuća učenika na kraju osnovnog školovanja*. Beograd, Institut za psihologiju.

Ilišin V. (2006). *Mladi između želja i mogućnosti: položaj, problemi i potrebe mladih Zagrebačke županije*. Zagreb: Institut za društvena istraživanja. Irby, I., Tolman, J. (2002). *Rethinking Leisure Time: Expanding Opportunities for Young People and Communities*. Washington, The Forum for Youth Investment.

Jeđud, I., Novak, T. (2006). Provođenje slobodnog vremena djece i mladih s poremećajima u ponašanju – kvalitativna metoda. *Revija za sociologiju*, 37 (1–2), 77–90.

Leburić, A., Relja, R. (1999). Kultura i zabava mladih u slobodnom vremenu. *Napredak*, 140 (2), 175-183.

Kaçiu, B., Daci, S. (2018). Roli i pjesmarrjes në aktivitete rekreative sportive dhe ndikimi i tyre në indeksin e masës trupore - (bmi) te nxënësit e dy komunave të Kosovës. Punim Masteri. Prishtinë: Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, Universiteti i Prishtinës.

Kouvonen, A., Kivimäki, M., Elovainio, M., Virtanen, M., Linna, A., & Vahtera, J. (2005). Job strain and leisure-time physical activity in female and male public sector employees. *Preventive Medicine*, 41(2), 532–539. <https://doi.org/10.1016/j.ypmed.2005.01.003>.

Kurshumlija, E & Hoxha, L. (2019). Dallimet në aktivitetet rekreativo-lëvizore ndërmjet femrave të Mitrovicës dhe Prishtinës. Punim i diplomës master. Prishtinë: Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, Universiteti i Prishtinës ``Hasan Prishtina``

Leino-Arjas, P., Liira, J., Mutanen, P., Malmivaara, A., & Matikainen, E. (2004). Predictors and consequences of unemployment among construction workers: Prospective cohort study. *BMJ*, 328(7437), 409. <https://doi.org/10.1136/bmj.37936.485210.0D>

Maksić, S. i Tenjović, L. (2008). Povezanost interesovanja i verbalna fluentnost kod učenika osnovne škole. *Psihologija*, Vol. 41 (3), str. 311-325.

Metushi, E.& Muça, F. (2019). Preferencat e marrjes me aktivitete rekreative dhe sportive si dhe shprehitë individuale tek nxënësit e komunës së ferizajit dhe suharekës. Punim i diplomës master. Prishtinë: Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, Universiteti i Prishtinës ``Hasan Prishtina``

Mlinarević, V., Brust, M., (2009). Kvaliteta provedbe školskih izvannastavnih aktivnosti, Osijek: Učiteljski fakultet.

Murseli, M. & Gjuraj, L. (2015). Shprehit individuale të jetesës dhe aktivitetet rekreative sportive. Punim i diplomës master. Prishtinë: Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, Universiteti i Prishtinës ``Hasan Prishtina``.

Nešić, M., Lolić, V., Srdić, V. i Meholjić-Fetahović, A. (2011). Indeks telesne mase kao činilac opredeljenja prema sportsko-rekreativnim aktivnostima na univerzitetu. *Sportske nauke i zdravlje*, 1(1):37-46.

Nešić, M., Tomašević, M., & Pantović, M. (2014). Lifestyle and recreational physical activity among middle-aged women. *Research in Physical Education, Sport and Health*, 3(2), 89–94.

Okano, G., Miyake, H., & Mori, M. (2003). Leisure time physical activity and self-rated health among middle-aged employees. *Journal of Occupational Health*, 45(6), 286–292. <https://doi.org/10.1539/joh.45.286>

Ostojic SM, Stojanovic M, Stojanovic V. i Maric J. (2010). Adiposity, physical activity and blood lipid profile in 13-year-old adolescents. *J Pediatr Endocrinol Metab*. 23(4):333-43.

Polić, R. (2003). Odgoj i dokolica. *Metodički ogledi*, 10 (2), 25–37.

Perasović, B. (2009). O (ne)mogućnosti upravljanja slobodnim vremenom; U: Andrijašević, M. (ur.): Upravljanje slobodnim vremenom sadržajima sporta i rekreacije, str. 47-59. Zagreb: Kineziološki fakultet Sveučilišta u Zagrebu.

Previšić, V. (2000). Slobodno vrijeme između pedagojske teorije i odgojne prakse. *Napredak* 141 (4), 403 – 410.

Proper, K. I., Koning, M., Van der Beek, A. J., Hildebrandt, V. H., Bosscher, R. J., & Van Mechelen, W. (2003). The effectiveness of worksite physical activity programs on physical activity, physical fitness, and health. *Clinical Journal of Sport Medicine*, 13(2), 106–117. <https://doi.org/10.1097/00042752-200303000-00008>

Rosić, V. (2005). Slobodno vrijeme — slobodne aktivnosti, Rijeka: Biblioteka Educo.

Salihu, Xh. (2021). Rëndësia ndaj aktiviteti fizik te maturantët. Punim i diplomës master. Prishtinë: Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit, Universiteti i Prishtines`Hasan Prishtina.

Sallis, J. F., Prochaska, J. J., & Taylor, W. C. (2000). A review of correlates of physical activity of children and adolescents. *Medicine & science in sports & exercise*, 963-975.

Schneider, S., & Becker, S. (2005). Prevalence of physical activity among the working population and correlation with work-related factors: Results from a cross-sectional study. *BMC Public Health*, 5, 105. <https://doi.org/10.1186/1471-2458-5-105>

Tatar, N. (2014). Fizičke aktivnosti u slobodnom vremenu mladih Crne Gore. Doktorska disertacija. Novi sad: Fakultet za sport i turizam, Univerzitet EDUCONS.

Thøgersen-Ntoumani, C., & Fox, K. R. (2005). Physical activity and mental well-being typologies in corporate employees: A mixed methods approach. *Work & Stress, 19*(1), 50–67. <https://doi.org/10.1080/02678370500057833>.

Vidaković-Samardžija, D., Pavelić-Karamatić, L. i Samardžija, D. (2011). Uticaj morfoloških karakteristika na motoričke i funkcionalne sposobnosti učenica. *Hrvatski kineziološki savez, 263-269*.